

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6096
E martë, 25 gusht 2020
çmimi 0.40 €

Thaçi kërkon nga
Kuvendi t'ia vazhdojë
mandatin Gjykatës
Speciale | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYEMINISTRI TAKOHET ME LIDERËT E KOALICIONIT QEVERISËS | FAQE 4-5

KOSOVA DO TË SHKOJË NË UASHINGTON PËR NJOHJE RECIPROKE

Partnerët e koalicionit qeverisës janë pajtuar që Kosova në takimin e Uashingtonit do të shkojë me qëndrime të qarta për procesin e dialogut me Serbinë. Lideri i Nismës, Fatmir Limaj, ka bërë me dije se çështja e dialogut ka qenë tema kryesore për të cilën ka biseduar kryeministri i Kosovës me liderët e tri partive të koalicionit qeverisës. Pas takimit, ai ka thënë se është qëndrim i përbashkët që Kosova në Shtëpinë e Bardhë të shkojë vetëm për njohje reciproke me Serbinë. Ai ka mohuar se në takimin e partnerëve të koalicionit është diskutuar për çështjen e presidentit



OPINION

ZOTËRI DICK MARTY, KUR DO TË TURPËROHENI E KËRKONI FALJE PËR ATO QË KENI SHKRUAR? (35) F. 11

Shkruan:
Kudusi LAMA



AKTUALE

HOTI PREMTON ANGAZHIM
MAKSIMAL PËR SHËNDETIN
DHE EDUKIMIN F. 6

KURTI E QUAN TË KOTË
QEVERINË HOTI F. 7

VESELI VIZITON STRUKTURAT
PARTIAKE NË SKENDERAJ,
KËRKON ANGAZHIM PËR FITORE F. 7

EKONOMI

NDAHEN 10 MILIONË EURO
PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE
TË KOMUNAVE F. 9

KRU 'PRISHTINA' NJOFTON PËR
GJENDJEN E LIQENEVE
BATLLAVË DHE BADOÇ F. 9

PËRFAQËSUES TË OAK-ut DHE
KUÇI DISKUTOJNË PËR
PËRKRAHJE TË BIZNESEVE F. 9

SPORT

SHTYHET FILLIMI I EDICIONIT TË
RI NË BASKETBALL F. 8



FLET PËR "EPOKËN E RE", FADIL BERJANI

SEKTORI I DERIVATEVE TË NAFTËS NË KOSOVË PO PËRBALLET ME SFIDA

Kryetari i Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës, Fadil Berjani, ka deklaruar se ky sektor është duke u ballafaquar me një varg sfidash në bazë të udhëzimeve administrative të cilat janë në kundërshtim me standardet e BE-së. Ai ka thënë për "Epokën e re"

se politikat qeveritare e kanë rënduar në masë të madhe këtë sektor. Në këtë kontekst, Berjani ka përmendur Udhëzimin Administrativ për pastrimin e rezervave të naftës, tak-sën e kyçjes në rrugë si dhe pagesën për licencë në bazë vjetore | FAQE 8-9



BIE NUMRI I RASTEVE TË REJA ME COVID,
POR JO EDHE I TË VDEKURVE | FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Qeveria e re në Maqedoni, pas zgjedhjes së nënkryetarëve të Kuvendit

Shkup, 24 gusht- LSDM-ja është shprehur e gatshme ta dorëzojë në Kuvend propozimin për përbërjen e re qeveritare brenda kësaj jave, por pa precizuar ditën. Kreu i kësaj partie dhe i propozuari për kryeministër, Zoran Zaev, ka deklaruar se fillimisht do të zgjidhen nënkryetarët e Kuvendit dhe të verifikohen mandatet e deputetëve të ardhshëm. Kurse ministri në largim i Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Damjan Mançevski, ka treguar se nënkryetarët do të zgjidhen së shpejti. “Unë besoj sot ose nesër, do të thotë këto ditë, do të dorëzohet propozimi për qeverinë e re dhe shpejt do të bëhet edhe votimi i qeverisë së re. Kështu që, më së voni javën

që vjen do ta kemi funksional pushtetin ekzekutiv. Sa iu përket komisioneve, gjithmonë ka qenë praktikë që të formohet komisioni për zgjedhje dhe emërimet dhe ai është parakusht që të mund të formohen organet e tjera të Kuvendit”, ka deklaruar Mançevski.

Zgjedhja e nënkryetarëve bëhet me marrëveshje mes partive parlamentare, por nuk është kusht për votimin e qeverisë. Madje, gjatë përbërjes së kaluar, nënkryetarët janë zgjedhur një vit pas konstituimit të Kuvendit. Qeveria e re duhet të votohet nga të paktën 61 deputetë, ndërsa koalicioni LSDM-BDI ka arritur ujdi për shumicën parlamentare.



Meta dekreton 12 rektorët e rinj të universiteteve publike

Tiranë, 24 gusht - Presidenti i Republikës, Ilir Meta, ka dorëzuar sot dekretet e emërimit rektorëve të universiteteve publike, të shpallur fitues nga zgjedhjet e 30 korrikut. Në ceremoninë e posaçme, ku 12 rektorë morën zyrtarisht detyrën, presidenti Ilir Meta ka thënë se ata janë zgjedhur përmes një procesi transparent. “Zgjedhja dhe përzgjedhja juaj erdhi nëpërmjet një procesi jo të lehtë, veçanërisht prej situatës së pazakonshme të pandemisë, të papriturave dhe përpjekjeve për t’u përshtatur me masa të cilat shpesh edhe u kontestuan. Prandaj edhe sfidat përpara jush janë të vështira, por jo të pamundura. Sfidat dhe vështirësitë me të cilat do të përballeni do të jenë të shumta, sidomos në këtë periudhë pandemie e cila kërkon edhe më shumë impenjim dhe strategji të veçantë për të



garantuar cilësi dhe studime sa më efektive. Me marrjen e detyrës suaj, ju nxis të punoni pa u lodhur për t’i transformuar universitetet në qendra më aktive shkencore”, ka deklaruar Meta. Kreu i shtetit ka vlerësuar se

Shqipëria ka sot më shumë se kurrë nevojë për shpresë! “Edukimi i mirë i rinisë është shpresa e madhe e vendit tonë. Duhet ndaluar largimi i trurit dhe i forcave të reja dhe më krijuese të shoqërisë. Largimi i rinisë dhe mbyllja e shumë

degëve të studimit në universitetet në mbarë vendin është një plagë shumë e madhe! U duhet ofruar të rinjve tanë më shumë shpresë e alternativa edukimi dhe pune. Shqipëria ka nevojë për ‘brain gain’ dhe jo ‘brain drain’”, është shprehur ai,

duke kërkuar angazhimin e tyre për forcimin e autoritetit të Institucioneve të Arsimit të Lartë. “Njëkohësisht tërheq vëmendjen tuaj dhe kërkoj angazhimin dhe vendosmërinë tuaj të plotë për forcimin e autoritetit të Institucioneve të Arsimit të Lartë, veçanërisht autonominë e universiteteve, duke i mbajtur ato sa më larg politikës dhe ndikimeve dhe qëllimeve të saj. Liria akademike, autonomia financiare dhe organizative në përputhje me legjislacionin në fuqi janë të rëndësishme për institucionet e arsimit të lartë në vendin tonë dhe vendosmëria e përkushtimi juaj për t’i mbrojtur ato duhet të jenë parimore dhe të pakompromis”, ka deklaruar Meta.

12 rektorët e rinj për katër vjetët e ardhshëm do t’i drejtojnë institucionet publike të arsimit të lartë në vend.

Talat Xhaferi, letër falënderimi Gramoz Ruçit

SHKUP, 24 GUSHT - Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, i ka dërguar letër falënderimi homologut shqiptar Gramoz Ruçi. Në këtë letër Xhaferi ka shkruar se me ndihmën e Ruçit shqiptarët e Maqedonisë së Veriut po bëhen faktorë të rëndësishëm në fuqizimin e shtetit demokratik dhe evropianizimin të këtij vendi. “Përkrahja

juaj nuk na ka munguar asnjëherë dhe me ndihmën tuaj, shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, ngadalë, por të sigurt, po bëhen faktorë të rëndësishëm për fuqizimin e shtetit demokratik dhe evropianizimin e vendit”, ka shkruar Xhaferi. Ai ka bërë me dije se bashkëpunimi në mes tyre nuk do të mungojë as në të ardhmen. “Falë bashkëpunimit të

shkëlqyeshëm gjatë mandatit të kaluar, arritëm ta fuqizojmë lidhjen Tiranë - Shkup dhe ky bashkëpunim nuk do të mungojë as në mandatin e ardhshëm katërvjeçar. Ju falënderoj për ftesën dhe shpresoj të shihemi së shpejti në Tiranë”, ka shkruar Xhaferi në letrën drejtuar kryetarit të Kuvendit, Gramoz Ruçi, të cilën e ka bërë publike në rrjetet sociale.



Raporti 24-orësh: 13 të vdekur, 152 të shëruar dhe 99 raste të reja me Covid në Kosovë

Bie numri i rasteve të reja me Covid, por jo edhe i të vdekurve

Ditët e fundit ka rënë numri i rasteve të reja me Covid-19, por jo edhe i të vdekurve nga ky infeksion në Kosovë. Brenda 24 orëve të fundit në vendin tonë janë paraqitur 99 raste të reja me Covid, kurse kanë vdekur 13 persona. IKShPK-ja ka bërë me dije se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar edhe 152 persona nga Covidi, duke e çuar në 8 657 numrin e përgjithshëm të të shëruarve. Sipas IKShPK-së, në Kosovë janë edhe 3 410 raste aktive me virusin "Korona"



Qendrat rajonale të shëndetësisë publike do të pajisen me aparate për RT-PCR

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije se janë duke u kryer procedurat për blerjen e shtatë aparateve të tjera për PCR në IKShPK, ku do të vihen në funksion në gjashtë qendrat rajonale të shëndetësisë publike. "Kemi rritur kapacitetet spitalore në Prishtinë dhe në komunat e tjera. Kemi porositur 120 000 vaksina kundër gripit sezonal përmes UNICEF-it dhe po zhvillojmë procedura edhe për 380 000 të tjera. Kapacitetet në sektorin publik i kemi rritur me rreth 300 ventilatorë, ndërsa kishim vetëm 82 sish. Në sektorin privat janë licencuar 86 institucione shëndetësore private për kryerje të testeve serologjike dhe PCR. Po kryejmë procedurat e blerjes së 7 aparateve të tjera për PCR në IKShPK, ku do të vihen në funksion në gjashtë qendrat rajonale të shëndetësisë publike (Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj e Gjiilan). Së shpejti do të kemi edhe: 7 aparate për RT-PCR, 100 000 teste PCR, 30 000 teste rapide dhe 100 000 teste serologjike", ka thënë Zemaj pas takimit me kryeministrin Hoti, ku kanë qenë të pranishëm edhe kryetarët e komunave.

Rreth 400 pacientë të infektuar me Covid po trajtohen në spitalet e Kosovës

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar të hënën se në institucionet publike shëndetësore në Kosovë aktualisht janë të shtrirë 508 pacientë, prej tyre 392 janë të prekur me koronavirus. Në raportin ditor të ShSKUK-së është thënë se 13 pacientë janë në respiratorë, 27 janë duke u trajtuar me makinat e frymëmarrjes CPAP, kurse 316 të tjerë janë në oksigjenoterapi. Kosova ka gjithsej 700 shtretër në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe në spitalet rajonale.

komuna Prishtinë 24 raste, komuna Pejë 19 raste, komuna Gjiilan 13 raste, komuna Podujevë 6 raste, komuna Prizren 6 raste, komuna Kaçanik 5 raste, komuna Viti 4 raste, komuna Ferizaj 3 raste, komuna Fushë Kosovë 3 raste, komuna Lipjan 3 raste, komuna Malishevë 2 raste, komuna Vushtrri 2 raste dhe me nga një rast komunat Deçan, Dragash, Drenas, Graçanicë, Kamenicë, Klinë, Mitrovicë, Rahovec dhe Suharekë", ka njoftuar IKShPK-ja, e cila drejtohet nga Naser Ramadani.

12 infermierë të FSK-së i bashkohen QKUK-së në luftën kundër Covidit

Dymbëdhjetë (12) infermierë të trajnuar nga Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) kanë arritur në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Ata kanë përfunduar të gjitha përgatitjet bazike dhe do të qëndrojnë në klinikat e QKUK-së për 30 ditë, varësisht nga nevoja, që ta ofrojnë ndihmën e nevojshme për pacientët e prekur me virusin Covid-19.

Ushtruesi i detyrës i drejtorit të ShSKUK-së, Valbon Krasniqi, ka thënë se prania e infermierëve të

FSK-së është dëshmi e një bashkëpunimi të shkëlqyeshëm në luftën ndaj pandemisë Covid-19. "Jam i privilegjuar që po fillon ky mision dhe kam shumë besim në profesionalizmin dhe kapacitetin e tyre, po ashtu edhe në ndihmën që do t'ua ofrojnë kolegëve tanë. Ky është vetëm fillimi. Në javët në vazhdim do të vijmë edhe ekipe të tjera", ka thënë Krasniqi.

Ndërsa ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka deklaruar se bashkëpunimi ndërinstytucional në ballafaqimin me pandeminë është duke dhënë rezultate

konkrete. "Ky aktivitet është një imputo i rëndësishëm në punën dhe përkushtimin të cilin po e bëjnë profesionistët shëndetësorë. Kjo tregon që bashkëpunimi ndërinstytucional dhe mobilizimi i përgjithshëm për ta luftuar pandeminë po jep rezultatet e veta", është shprehur Zemaj.

Në anën tjetër, Shkëlzen Sylja, drejtor i përgjithshëm i Qendrës Mjekësore të Forcës së Sigurisë së Kosovës, ka thënë se infermierët do të ndahen në katër njësi dhe, fillimisht, do ta nisin punën në Klinikën Infektive.

EPOKA ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 24 GUSHT - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e kaluara kanë vdekur 13 persona të cilët kanë qenë të infektuar me koronavirus. Po ashtu, IKShPK-ja ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë paraqitur edhe 99 raste të reja me Covid si dhe janë shëruar 152 persona. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK me metodën RT-PCR dhe në laboratorët privatë janë testuar gjithsej 406 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 99 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 13 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Numri total i rasteve pozitive është 12 547 raste nga 47 761 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 480 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 152 pacientë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 8 657 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 410", ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar rastet me Covid sipas komunave të Kosovës. "Rastet pozitive janë nga:



Zemaj: Vaksina për Covid-19 do të jetë falas

Ministri i Shëndetësisë i Kosovës, Armend Zemaj, ka thënë se Qeveria e Kosovës është në rrugën e duhur për sigurimin e vaksinave kundër Covid-19. Pa përmendur sasinë, Zemaj ka thënë se është duke u punuar që të sigurohen vaksinat kundër Covid, të cilat, sipas tij, do të jepen falas për qytetarët e Kosovës. "Jemi në hapa konkretë dhe që mendojmë të realizueshëm, nëse vaksina nxirret në përdorim, që edhe ne ta sigurojmë për të gjithë qytetarët e

Republikës së Kosovës. Tash mbetet një vlerësim i yni në të dyja rrugët. Unë si ministër i Shëndetësisë obligohem dhe zotohem që duhet ta siguroj për të gjithë qytetarët e mi, pavarësisht çmimit apo mënyrës, se si të arrijë që ajo vaksinë të jetë për qytetarët e Republikës së Kosovës. Unë do t'i vaksinohet falas", është zotuar Zemaj. Ndërsa sa i përket pagës shtesë për punëtorët shëndetësorë, Zemaj ka thënë që kjo do të vazhdojë deri në përfundim të pandemisë.



Kryeministri takohet me liderët e koalicionit qeverisës

Kosova do të shkojë në Uashington për njohje reciproke

Partnerët e koalicionit qeverisës janë pajtuar që Kosova në takimin e Uashingtonit do të shkojë me qëndrime të qarta për procesin e dialogut me Serbinë. Lideri i Nismës, Fatmir Limaj, ka bërë me dije se çështja e dialogut ka qenë tema kryesore për të cilën ka biseduar kryeministri i Kosovës me liderët e tri partive të koalicionit qeverisës. Pas takimit, ai ka thënë se është qëndrim i përbashkët që Kosova në Shtëpinë e Bardhë të shkojë vetëm për njohje reciproke me Serbinë. Ai ka mohuar se në takimin e partnerëve të koalicionit është diskutuar për çështjen e presidentit

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 24 GUSHT - Lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka bërë me dije se çështja e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka qenë tema kryesore për të cilën kanë biseduar kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, me liderët e tri partive të koalicionit qeverisës. Pas takimit,

ai ka thënë Kosova në këtë takim do të shkojë për njohje reciproke. "Biseduam për temat aktuale në vend. U informuam nga kryeministri për gjendjen me Covid, për paketën e rimëkëmbjes ekonomike, për parapërgatitjet për vitin e ri arsimor. Një nga temat kryesore ishte dialogu. Siç e dini, tash Kosova i ka disa ftesa në tavolinë që të marrë pjesë në dialog, njëherë në takimin e

Uashingtonit, pastaj në të Brukselit", ka thënë Limaj. Ai ka vlerësuar se është marrëveshje e përbashkët e partnerëve të koalicionit, që Kosova duhet ta vazhdojë procesin e dialogut me Serbinë. "Ka qenë një shqetësim i përbashkët dhe, në fund, një marrëveshje e përbashkët, që Kosova do të vazhdojë të marrë pjesë në dialog, me agjendë të qartë, me principe

të qarta. Ato kompromise që i ka bërë Kosova, heqja e taksës dhe reciprociteti dhe të gjitha ato kërkesa për t'u kthyer në dialog, i ka bërë për njohje. Ne shkojmë në dialog për njohje", ka thënë ai, duke shtuar se tani është koha për një marrëveshje gjithëpërfshirëse në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Shqetësimin tonë, se dialogu mund të rrëshqasë në dialog teknik, duhet ta eliminojmë. Delegacioni i Kosovës, kushdo që shkon atje, duhet të jetë i fokusuar në temën e dialogut për njohje. Ashtu siç ka thënë kancelarja Merkel, presidenti Macron dhe më herët presidenti Trump, koha është për një marrëveshje gjithëpërfshirëse, e cila ka njohjen reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka deklaruar ai. Sipas tij, Kosova nuk është e interesuar të futet në lojën e stërzgjatjes së këtij

procesit. "Në Uashington Kosova do ta demonstrojë vullnetin se është e interesuar që shpejt të vijë deri te një marrëveshje, pra marrëveshje për njohje reciproke. Kështu e ka bërë dhe do ta bëjë edhe në Bruksel dhe kudo që të jetë. Ne nuk jemi të interesuar të futemi në lojën e stërzgjatjes së ashtuquajturave tema teknike, të cilat do të na kthenin në një dialog që ka ndodhur nga viti 2011 në Bruksel", ka theksuar Limaj. Ai ka deklaruar se e rëndësishme është që kryeministri i Kosovës në Uashington do të shkojë me disa qëndrime të qarta. "Ne kemi diskutuar çka kryeministri i vendit tonë do të paraqesë në tavolinë të bisedimeve. Kjo është shumë e rëndësishme për ne, pastaj cilat tema do të trajtohen atje është çështje e nikoqirëve. Mirëpo Kosova do të shkojë me disa



diskutimeve. “Kosova e ka presidentin. Qëndrimi zyrtar i Nismës është se Kosova e eka presidentin e vet dhe nuk është temë e diskutimit. Bile, për mendimin tim, të diskutohet kjo temë në këtë kohë është e turpshme. Nuk e kemi diskutuar këtë temë sepse nuk është pjesë e diskutimeve”, është shprehur Limaj.

Pak para këtij takimi anëtari i Këshillit Kombëtar i partisë Nisma Socialdemokrate, Leotrim Berisha, ka thënë se kandidat ideal për president të vendit do të ishte Fatmir Limaj. Në profilin e vet në “Facebook”, ai ka shkruar se në to gjashtë vjetët e fundit Fatmir Limaj ka dëshmuar se është politikan që asnjëherë nuk e ka vendosur interesin partiak para atij shtetëror. “Megjithatë, me përfundimin e mandatit të presidentit aktual vendit i duhet një president unifikues, dikush që nuk nxit përçarje në shoqëri dhe i cili mund t’i bëjë bashkë pozitë e opozitë sa herë që ka nevojë vendi. Por, kush do të ishte ideal për president? Fatmir Limaj në ta gjashtë vjetët e fundit si kryetar partie ka dëshmuar se është politikan që asnjëherë nuk e vendos interesin partiak para atij shtetëror. Fatmir Limaj në vitin 2014 ishte ideator i formimit të LAN-it (më pas VLAN) si nevojë e domosdoshme për ndryshim të pushtetit në vend asokohe”, ka shkruar Berisha.

Ky reagim i Nismës ka ardhur pasi dy partnerët e tjerë të koalicionit qeverisës, LDK-ja dhe AAK-ja, kanë shprehur ambicie për këtë post. Fillimisht, Këshilli Drejtues i AAK-së ia ka dhënë besimin Ramush Haradinajt që të jetë kandidat për president. Më pas, Haradinaj ka treguar arsyet se pse e synon këtë post. “Aleanca është para dy zgjidhjeve, të dyja shumë të vështira. E para është që të vazhdojë të jetë pjesë e pushtetit dhe e vendimmarrjes, por ta kushtëzojë me marrjen e një pozicioni vendimmarrës të presidentit. Dhe kjo është logjika pse Këshilli Drejtues i AAK-së ma ka dhënë autorizim të negocioj edhe për çështjen e presidentit, me qëllim që ne të mos përjashtohemi nga tavolina e marrjes së vendimeve”, ka thënë Haradinaj.

Një ditë më parë sekretari i përgjithshëm i LDK-së, Arban Abrashi, ka thënë se ky post i takon LDK-së. “Nuk është diskutuar asnjëherë se cilës parti duhet t’i takojë, por unë besoj se edhe LDK-ja si një parti shtetformuese, e cila ka dhënë shumë për vendin, edhe i ka numrat në Kuvend, i takon posti i presidentit”, ka deklaruar Abrashi.

Edhe nga AKR-ja kanë thënë se kandidat i tyre është Behgjet Pacolli, lider i kësaj partie.

Thaçi dhe mandati i tij përfundon në pranverë, por mund të japë edhe dorëheqje nëse i konfirmohet aktakuza nga Gjykata Speciale.

Thaçi kërkon nga Kuvendi t’ia vazhdojë mandatin Gjykatës Speciale

PRISHTINË, 24 GUSHT (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka kërkuar që mandati i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar të zgjasë deri kur njoftimi i përfundimit të mandatit të kësaj gjykate bëhet nga Këshilli i Bashkimit Evropian në konsultim me Qeverinë e Republikës së Kosovës. Përmes një video-mesazhi në llogarinë e vet në “Facebook”, ai ka thënë se politika nuk duhet të ndërhyjë

në drejtësi dhe as drejtësia në politikë. Ai ka deklaruar se Kosova ka nevojë për qartësi sa i përket mënyrës sesi mbyllen Dhomat e Specializuara. “Politika nuk duhet të ndërhyjë në drejtësi dhe as drejtësia në politikë. Kjo ishte bindja ime në çdo hap të mbështetjes për krijimin e gjykatave ndërkombëtare dhe paneleve speciale në këto njëzet vitet e fundit. Kjo vazhdon të jetë bindja ime edhe tash kur nga Kuvendi i Republikës së

Kosovës po kërkoj që mandati i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar të zgjasë deri kur njoftimi i përfundimit të mandatit të bëhet nga Këshilli i Bashkimit Evropian në konsultim me Qeverinë e Republikës së Kosovës. Kemi nevojë për qartësi sa i përket mënyrës sesi mbyllen Dhomat e Specializuara, prandaj besoj se deputetët do ta përkrahin këtë iniciativë timen”, ka deklaruar Thaçi.



Hyseni takon ambasadorin Abbott, flasin për dialogun Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 24 GUSHT - Koordinator i shtetëror për dialog me Serbinë, Skënder Hyseni, ka pritur sot në takim ambasadorin e Britanisë së Madhe, Nicholas Abbott, me të cilin ka biseduar për rrjedhën e deritashme të dialogut Kosovë - Serbi.

Në profilin e vet në “Facebook”, ai ka shkruar se rëndësi të veçantë ka përkrahja e mëtejme britanike për proceset nëpër të cilat po kalon Kosova. “Sot prita në zyrën time ambasadorin e Britanisë së Madhe, Nicholas Abbott. Bëmë një bisedë të hapur për rrjedhën e deritashme të dialogut Kosovë - Serbi. Duke çmuar lart kontributin e madh të Britanisë së Madhe në të gjitha fazat e historisë më të re dhe shtetndërtimit në Kosovë, theksova rëndësinë e veçantë që ka përkrahja e mëtejme britanike për proceset nëpër të



cilat po kalon vendi ynë”, ka shkruar Hyseni.

Ai ka vlerësuar se Britania e Madhe përkrah arritjen e një marrëveshje finale në mes të Kosovës dhe Serbisë. “Ambasadori Abbott, nga ana e tij, tha se përkushtimi dhe

angazhimi i Mbretërisë së Bashkuar, për një marrëveshje të drejtë dhe të qëndrueshme që duhet të sjellë normalizim të plotë në marrëdhëniet midis Kosovës dhe Serbisë, është i palëkundshëm”, ka shkruar Hyseni.

qëndrime të qarta në Uashington. Delegacionin do ta udhëheqë kryeministri i Kosovës me delegacionin që do ta ndërtojë ai”, është shprehur Limaj.

Lideri i Nismës ka folur edhe për qëndrueshmërinë e koalicionit qeverisës. Sipas tij, ai është funksional përderisa ka korrektësi në mes të partnerëve të koalicionit. “Koalicioni është ky që është. Është i qëndrueshëm për aq sa ka partneritet korrekt, në funksion të kryerjes së detyrave shtetërore. Në momentin kur nuk ka korrektësi, nuk duhet të ketë koalicione të improvizuara të cilat nuk janë në shërbim të temave që folëm”, ka deklaruar Limaj.

I pyetur për mundësinë e zgjerimit të koalicionit qeverisës, ai ka thënë se çdoherë është për një qeveri të gjerë. “Unë gjithmonë jam për një qeverisje të gjerë, stabile dhe të fuqishme, e cila merr përgjegjësi për trajtimin e këtyre temave që janë të ndjeshme për vendin”, ka thënë Limaj.

Për pozitën e presidentit nuk është diskutuar

Lideri i Nismës ka mohuar se është diskutuar në këtë takim çështja e pozitës së presidentit. Ai ka thënë se vendi ka president dhe kjo çështje nuk është temë e

Kryeministri Avdullah Hoti ka takuar kryetarët e komunave

Hoti premtion angazhim maksimal për shëndetin dhe edukimin

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, është zotuar se do të ketë angazhim maksimal për shëndetin dhe edukimin. Në takim me kryetarët e komunave mbajtur të hënën, ai ka diskutuar rreth menaxhimit të pandemisë dhe përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor

“Epoka e re”

PRISHTINË 24 GUSHT - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, ka takuar të hënën kryetarët e komunave, me të cilët ka diskutuar për bashkërendimin e aktiviteteve për menaxhimin e përhapjes së pandemisë Covid-19 si dhe për përgatitjet që po bëhen për fillimin e vitit të ri shkollor. Në fjalën e tij hyrëse, kryeministri Hoti ka falënderuar kryetarët e komunave për punën që po bëjnë për ta kaluar sa më lehtë gjendjen aktuale si pasojë e pandemisë Covid-19. “Bashkë me ministrat sot jemi për të diskutuar me ju për tri çështje kryesore, për të cilat do të flasin ministrat veç e veç, duke filluar nga zëvendëskryeministri Goran Rakiq, ministri Ramë Likaj dhe ministri Armend Zemaj. Dua t’ju falënderoj sinqerisht për angazhimin që e keni bërë tash e shtatë ju, ekipi juaj,

bashkëpunëtorët, drejtorët, shtabet komunale dhe lokale që i keni në bashkëpunim të rregullt me juve”, ka thënë kryeministri Hoti.

Ai ka treguar se tashmë janë mbajtur disa diskutime përmes platformave online. Në këtë kontekst, ai ka vlerësuar se është shumë mirë që sot po takohen në këtë sallë, në këtë pritje të fillimit të ri shkollor dhe në vlerësim të situatës dhe masave që i kanë marrë deri më tash sa i përket pandemisë dhe masave për menaxhimin e pandemisë Covid-19.

Kryeministri Hoti ka deklaruar se gjithmonë ka një hapësirë për bashkëpunim më efikas, më të mirë në mes të ministrave dhe komunave, duke shtuar se për këtë është i vetëdijshëm që po merren çdo ditë, çdo natë me ekipet që janë në terren për ta mbikëqyrë zbatimin e masave. “Dhe, them me kënaqësi që trendi i rasteve të reja ka filluar të bjerë, por kjo nuk është shenjë



që ne ia kemi dalë në krye dhe e kemi futur plotësisht nën kontroll këtë pandemi, duke qenë se numri i rasteve me fatalitet mbetet mjaft i lartë dhe plot familje po humbin të dashurit e tyre”, ka deklaruar Hoti.

Më tej, kryeministri ka deklaruar se janë duke u bërë përgatitjet e duhura për fillimin e vitit të ri shkollor. “Gjithashtu, jemi edhe para fillimit të ri shkollor. Ministri i Arsimit me bashkëpunëtorët ka bërë një punë të mirë për studimin e përvojave të vendeve të ndryshme sa i përket fillimit të ri shkollor, duke pasur parasysh edhe shëndetin e nxënësve, të arsimtarëve në shkolla, por në të njëjtën kohë për t’u siguruar që

nuk mbetemi mbrapa sa i përket realizimit të planprogramit dhe sigurimit të cilësisë në arsim”, ka deklaruar Hoti.

Ndërsa ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, pas takimit, ka deklaruar se në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe IKShPK-në kanë përgatitur hapjen e shkollave më 1 shtator në tri faza për të gjitha nivelet e arsimit. “Viti i ri shkollor do të fillojë më 1 shtator për parashkollorët dhe për klasat 1, 2, 3 si dhe 6 dhe 9, pastaj për klasat 4 dhe 5 do të fillojë në fazën e dytë më 7 shtator, kurse në fazën e tretë më 10 shtator do ta fillojnë mësimin klasat 7, 8, 9, 10 dhe 11, 12, sipas tre skenarëve të paraqitur”, ka deklaruar Likaj. Ai ka treguar se

mësimi për disa kategori, siç është për klasat 7, 8, 9 dhe 11 mund të jetë mësim i kombinuar, dy ditë në shkollë dhe tri ditë në shtëpi. “Kemi bërë përgatitjet edhe për mësimin nga distanca për ta, për shkak të ekspozimit të rrezikut”, ka deklaruar ministri.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka përgatitur tre skenarë të ndryshëm për fillimin e vitit të ri shkollor në kohë pandemie: skenari “A”, rikthimi në ambientet shkollorë të nxënësve; skenari “B”, mësimi i kombinuar; dhe skenari “C”, mësimi nga platforma të ndryshme. Por, ende nuk është vendosur përfundimisht se në bazë të cilit skenar do të fillojë viti shkollor.

Ministria e Arsimit publikon udhëzimet për fillimin mësimor në shtator

PRISHTINË, 24 GUSHT (ER) - Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) ka publikuar disa udhëzime për fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021. Kjo ministri ka theksuar se në bashkëpunim me partnerët kanë udhëzuar shkollat që të përgatiten për të tre skenarët të cilët do të zbatohen në shkolla, varësisht nga situata epidemiologjike dhe rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës.

“Ministri Likaj, kabineti i MASH-it dhe departamentet përkatëse në MASH janë mobilizuar që me bashkëpunim të mirë të të gjithë aktorëve, përfshirë DKA-në, shkollat, mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit e donatorët, do të bëhet e mundur që t’u përgjigjemi me sukses sfidave të shumta që paraqet organizimi i mësimor në kushtet e pandemisë Covid-19 në shkollat e Kosovës”, ka njoftuar MASH-i.

FALEMINDERIT

Rreth **30 mijë** mësimdhënësve të të gjitha niveleve të arsimit publik dhe privat në Kosovë.

#PresidentiIKosoves

Presidenti Thaçi falënderon mësimdhënësit e të gjitha niveleve në Kosovë

PRISHTINË, 24 GUSHT (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka falënderuar 30 mijë mësimdhënës të niveleve të arsimit

publik dhe privat në Kosovë. Shefi i shtetit këtë falënderim e ka bërë në prag të fillimit të vitit të ri shkollor, i cili pritet të fillojë më 1 shtator. “Faleminderit

rreth 30 mijë mësimdhënësve të të gjitha niveleve të arsimit publik dhe privat në Kosovë”, ka shkruar Thaçi në shkrimin publikuar në “Facebook”.



Veseli viziton strukturat partiake në Skenderaj, kërkon angazhim për fitore



SKENDERAJ, 24 GUSHT (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka vazhduar agjendën e takimeve në terren. Pas Ferizajt e Kaçanikut, ai ka takuar strukturat e PDK-së në Skenderaj. Veseli ka folur për nevojën e një angazhimi edhe më të madh në shërbim të vendit dhe përmbushjes së pritjeve të qytetarëve të Kosovës.

“Kosova ndodhet në një situatë aspak të lehtë. Sfidat që ka para vetes janë të mëdha, por edhe të përballueshme. Ne kemi ditur të tejkalojmë çaste historike të vështira, kur jemi bashkuar dhe kemi qenë në rrugën e drejtë. PDK-ja është parti shtetformuese që buron nga lufta për liri e çlirim e popullit të Kosovës dhe do të di si të silllet”, ka thënë Veseli. Ai ka kërkuar nga

kryesia e Degës së PDK-së në Skenderaj që të punojë pandërprerë për t'i sjellë fitore të reja partisë dhe që asnjëherë të mos e humbasë besimin në këtë parti. Ndërsa kryetari i Degës së PDK-së në Skenderaj, Sami Lushtaku, ka falënderuar kryetarin Veseli për vizitën, duke premtuar angazhim dhe mobilizim edhe më të madh të partisë në nivel komune.

Hoxhaj e krahason Vuçiqin me Lukashenkon

PRISHTINË, 24 GUSHT - Ish-ministri i Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj, në një opinion të publikuar në gazetën prestigjioze austriake “Der Standard”, ka shkruar për ngjarjet e fundit në Bjellorusi, për të cilat ka thënë se janë një provë për Ballkanin nëse regjimet e tilla autoritare do t'i përkasin së kaluarës apo do të jenë e ardhmja në Evropën Lindore dhe Juglindore. Përmes këtij opinion, ish-ministri Hoxhaj ka dhënë disa mendime rreth gjendjes në Bjellorusi dhe për ndikimin e tyre në Ballkan e më gjerë. “Shumë popuj në Ballkan e kanë përjetuar tashmë dramën Bjelloruse kur vepruan kundër diktatorëve të ngjashëm, por Lukashenko nuk duket se është i vetmi në Evropë me sjellje autoritare. Ngjarjet e Bjellorusisë janë gjithashtu një provë për Ballkanin nëse regjimet e tilla janë një gjë e së kaluarës apo nëse ato madje do të jenë e

ardhmja në Evropën Lindore dhe Juglindore”, ka shkruar Hoxhaj. Ai ka vlerësuar se metodat e Lukashenkos, siç është arrestimi i anëtarëve të opozitës, gazetarëve dhe aktivistëve ose markës së tyre si “kolonë e pestë”, janë të ngjashme me ato të presidentit serb Aleksandër Vuçiq.

Në opinionin e tij të titulluar: “Bjellorusia: Një provë për botën demokratike”, Hoxhaj ka thënë se rezultati i zgjedhjeve në Bjellorusi ishte i lehtë për t'u parashikuar. Sipas tij, ishte e qartë se autoritetet elektorale të kontrolluara Bjelloruse do ta shpallnin Aleksandër Lukashenkon fitues. “Pasiguria e vetme ishte nëse ai dëshironte ta kapërcejë mentorin e tij Vladimir Putin me rezultatin e zgjedhjeve!”, ka shkruar Hoxhaj. Në formë të ngjashme, Hoxhaj ka thënë se edhe Vuçiqi ka arritur t'i marrë 60 për qind të votave në zgjedhje. “Bojkoti i opozitës serbe nuk ishte asgjë



për t'u shqetësuar. Si Lukashenko për Bashkimin Sovjetik, Vuçiqi ende tregon nostalgji për Sllobodan Milosheviqin dhe Jugosllavinë. Një arsye më shumë që Brukseli ta mbrojë demokracinë në tokën evropiane!”, ka thënë ai.

Zyrtari i PDK-së, Enver Hoxhaj, gjithashtu ka shkruar se sa më shumë njerëz në Bjellorusi të dalin në rrugë, aq më shumë udhëheqës autoritarë nga e gjithë bota qëndrojnë prapa Lukashenkos. “Ata i ofrojnë mbështetje dhe duan t'u trego-

jnë qytetarëve të tyre se nuk do të heqin dorë nga pushteti i tyre pa dhunë. Bjellorusia tani është futur në një betejë tipike të kohës sonë midis demokracisë dhe autoritarizmit. Si e tillë ajo perceptohet në Ballkan”, ka shkruar ai.

Kurti e quan të kotë qeverinë Hoti

Ish-kryeministri i Kosovës dhe lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, e ka quajtur të kotë qeverinë e drejtuar nga Avdullah Hoti. Në këtë kontekst, Kurti ka thënë se qeveritë të cilat patën qeverisur para tij kanë pasur prioritet pasurimin korrptiv. “Qeveritë para nesh kishin prioritet pasurimin korrptiv për vete dhe liberalizimin e vizave për qytetarët. Qeveria sot është kot. Kemi mungesë të rrjetës sociale që siguron familjet në nevojë dhe kemi tepri të pandemisë që ka dalë nga kontrolli institucional”, ka thënë Kurti

“Epoka e re”

PRISHTINË, 24 GUSHT (ER) - Ish-kryeministri Albin Kurti ka deklaruar se qeveritë e mëherëshme kanë pasur prioritet pasurimin korrptiv për vete dhe liberalizimin e vizave për qytetarët. Kurti ka vlerësuar se qeveria e drejtuar nga Avdullah Hoti është kot. Në profilin e vet në “Facebook”, Kurti ka shkruar se janë shqetësuese të gjeturat sociale sipas anketës të pub-

likuar së fundi nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). “Mjerimi social nuk është fatkeqësi natyrore. Qeveritë para nesh kishin prioritet pasurimin korrptiv për vete dhe liberalizimin e vizave për qytetarët. Qeveria sot është kot. Kemi mungesë të rrjetës sociale që siguron familjet në nevojë dhe kemi tepri të pandemisë që ka dalë nga kontrolli institucional. Nevojitet model i ri ekonomik, i përqendruar te punësimi dhe mjedisi e i mbrojtur nga



drejtësia dhe qeverisja e mirë. Pas zgjedhjeve të reja, nis zgjidhja e këtillë. Mbase zgjedhjet po orvaten t'i vonojnë ca, pikërisht pse të gjitha subjektet ua dinë rezultatin atyre”, ka thënë Kurti. Më tutje, Kurti ka thënë se në Kosovë jetohej keq. Sipas tij, janë shqetësuese të gjeturat sociale sipas anketës të pub-

likuar së fundi nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). “Rezultatet janë për të ardhurat dhe kushtet e jetesës në Kosovë në vitin 2018. E gjendja mund të jetë veçse e përqesuar që prej atëherë. Për 53.4 për qind e ekonomive familjare janë barrë e rëndë shpenzimet për strehim dhe banim. Më shumë se çdo e

pesta familje ka probleme me kulm apo çati që rrjedh, mure, dysheme, themele të lagështa, kornizat e dritareve dhe dysheme të kalbur. 69.5 për qind nuk mund ta përballojnë një javë pushimi larg shtëpisë. 61.3 për qind nuk mund ta përballojnë shujtën me mish, pulë dhe peshk çdo të dytën ditë. 47.3 për qind nuk mund ta përballojnë një shpenzim të papritur prej 100 eurosh. 35.4 për qind nuk kanë kompjuter. 40.2 për qind nuk janë në gjendje ta përballojnë mbajtjen e shtëpisë të ngrohtë në mënyrë adekuate. 61.3 për qind e kanë barrë të rëndë kthimin e kreditë. 78.3 për qind kanë vështirësi për kryerjen e pagesave të nevojshme marrë parasysh të ardhurat totale. Më shumë se çdo e pesta familje në zonat urbane ka probleme me ndotje, papastërti dhe probleme të tjera mjedisore si: tymi, pluhuri, erëra të pakëndshme ose ujë të ndotur”, ka deklaruar Kurti.



Flet për “Epokën e re”, Fadil Berjani

Sektori i derivateve të naftës në Kosovë po përballlet me sfida

Kryetari i Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës, Fadil Berjani, ka deklaruar se ky sektor është duke u ballafaquar me një varg sfidash në bazë të udhëzimeve administrative të cilat janë në kundërshtim me standardet e BE-së. Ai ka thënë për “Epokën e re” se politikat qeveritare e kanë rënduar në masë të madhe këtë sektor. Në këtë kontekst, Berjani ka përmendur Udhëzimin Administrativ për pastrimin e rezervave të naftës, taksën e kyçjes në rrugë si dhe pagesën për licencë në baza vjetore. Ai ka thënë se vetëm në Kosovë ndodh që të paguhen çdo vit këto taksa. Sipas tij, një gjë e tillë duhet të ndodhë vetëm kur të merret licenca

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 24 GUSHT - Kryetari i Shoqatës së Naftëtarëve, Fadil Berjani, ka thënë se ky sektor është duke u përballur me një varg sfidash edhe për shkak të udhëzimeve administrative dhe politikave qeveritare, të cilat, sipas tij, e kanë rënduar tej mase këtë sektor. Ai në këtë intervistë për “Epokën e re” ka thënë se

Kosova qëndron larg standardeve të Bashkimit Evropian (BE) sa i përket sektorit të derivateve të naftës. Berjani ka thënë se Kosova ka udhëzime dhe vendime të cilat nuk aplikohen në asnjë vend të BE-së siç është pagesa e licencave në baza vjetore, çështja kohore e pastrimit të rezervave të naftës, si dhe pagesat e larta për kyçje në rrugë. “Ky sektor ka shumë sfida. Besojmë dhe shpresojmë se do


të rregullohen gjërat. Ne si përfaqësues të Shoqatës së Naftëtarëve kemi pasur takim me ministrin e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Vesel Krasniqi, ku kemi prezantuar problemet në këtë sektor dhe ai na ka premtuar bashkëpunim dhe realizim të kërkesave tona. Kërkesat tona janë që të jemi edhe ne pjesë e standardeve evropiane të BE-së. Pos të tjerash, kemi kërkuar që Ligji i

Naftës të kalojë sa më shpejt, pasi askund në botë në sektorin e naftës nuk paguhen licenca çdo dy vjet, por duhet të jenë të përhershme”, ka deklaruar Berjani, duke shtuar se sfidueset për naftëtarët mbetet edhe taksa për kyçje në rrugë. “Kjo taksë është ngarkesë për bizneset, ku paguhet çdo vit dhe do të duhej të paguhej vetëm kur të merret leja e ndërtimit. Shpresoj se ky problem do të rregullohet nga ministri Arban Abrashi. Presim që shumë shpejt ta kemi një takim me të dhe t’i shpallim sfidat tona”, ka thënë ai. Në këtë intervistë Berjani ka folur edhe për cilësinë e derivateve të naftës dhe për çmimin e tyre. “Vlen ta theksoj se çmimet do të jenë deri në një euro. Për naftë çmimet pritet të jenë 0.99 centë, kurse për benzinë një euro”, është shprehur Berjani. Sa i përket cilësisë së naftës, ai ka thënë se Kosova ka arritur që ta

kontrollojë naftën deri në 70 për qind. “Ne si shoqatë kemi qenë zë i fuqishëm që kontrolli i cilësisë së naftës të bëhet në kufi dhe deri më tani Dogana e Kosovës ka arritur ta kontrollojë cilësinë deri në 70 për qind, por me këtë përqindje nuk jemi të kënaqur”, ka thënë Berjani.

“Epoka e re”: Z. Berjani, sa dhe si ka ndikuar pandemia në sektorin e naftës?

Berjani: Sa i përket sektorit të naftës, pandemia e ka dëmtuar këtë sektor, edhe pse dihet që pikat e karburantit në fillim të pandemisë kanë punuar me kapacitet prej 5 deri në 10-përqindësh. Ndërsa në këtë kohë pikat e karburantit janë duke punuar me kapacitet rreth 80 për qind, pasi masat e qarkullimit ndikojnë në lëvizjen e qytetarëve dhe kjo është krejt normale dhe se duhet të respektohen masat.



sfiga. Besojmë dhe shpresojmë se do të rregullohen gjërat. Ne si përfaqësues të Shoqatës së Naftëtarëve kemi pasur takim me ministrin e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Vesel Krasniqi, ku kemi prezantuar problemet në këtë sektor dhe ai na ka premtuar bashkëpunim dhe realizim në kërkesat tona. Kërkesat tona janë që të jemi edhe ne pjesë e standardeve evropiane të BE-së. Pos të tjerash, kemi kërkuar që Ligji i Naftës të kalojë sa më shpejt, pasi askund në botë në sektorin e naftës nuk paguhen licenca çdo dy vjet, por duhet të jenë të përhershme.

“Epoka e re”: Po ashtu, ju keni pasur vërejtje edhe sa i përket Udhëzimit Administrativ për pastrimin e rezervave të naftës?

Berjani: Ministri Krasniqi na ka premtuar ndryshimin e udhëzimeve administrative të cilat janë në kundërshtim me standardet e BE-së. Pastrimi i rezervave është aprovuar që të bëhet çdo tri vjet dhe këtë e kemi kundërshtuar dhe ministri Krasniqi na ka premtuar se do ta ndryshojë sipas kërkesës së naftëtarëve. Pra, pastrimi të bëhet çdo 15 vjet, pasi ky është edhe standard i BE-së. Sfidë tjetër, po ashtu, e kemi paraqitur edhe kalibrimin e pikave rrjedhëse (pishtole), që çmimi ka qenë në për një pikë rrjedhëse 10 euro, kurse me udhëzimin e ri është 26 euro, gjë që edhe për këtë ministri Krasniqi na ka premtuar se do të kthehet në çmimin e mëparshëm, që ishte 10 euro. Shpresoj se këto premtime të ministrit Krasniqi nuk do të jenë boshe.

“Epoka e re”: Sa pika karburanti i ka Kosova dhe a duhet të lejohen të ndërtohen edhe pika të tjera?

Berjani: Sa i përket pikave të karburantit, aktualisht janë 750 pika, ndërsa sa i përket çështjes se a duhet të lejohet të ndërtohen edhe më tutje, ne nuk jemi kundër ndërtimit të tyre, por ato duhet të jenë në kuadër të standardeve të Bashkimit Evropian (BE). Standard duhet të jetë çështja e largësisë apo distancës nga pika në pikë. Në

rrugë lokale duhet të jetë 10 kilometra, në magjistrale 15 kilometra dhe në autostradë 25 kilometra. Rast konkret në autostradën “Ibrahim Rugova” është respektuar standardi i largësisë.

“Epoka e re”: Sa pika karburanti janë në pjesën veriore të Kosovës?

Berjani: Sa i përket Mitrovicës së Veriut, janë 50 pika të karburantit, ndërsa me licencë të Republikës së Kosovës punojnë përafërsisht 10.

“Epoka e re”: Z. Berjani, një nga sfidat është edhe taksa për kyçje në rrugë. Çfarë është bërë në këtë drejtim?

Berjani: Kjo taksë është ngarkesë për bizneset, ku paguhet çdo vit dhe do të duhej të paguhej vetëm kur të merret leja e ndërtimit. Shpresoj se ky problem do të rregullohet nga ministri Arban Abrashi. Presim që shumë shpejt ta kemi një takim me të dhe t'i shpallim sfidat tona.

“Epoka e re”: Sa është pagesa për këtë taksë?

Berjani: Taksa për kyçje rrugore ka koston deri në 1 800 euro në vit.

“Epoka e re”: Z. Berjani, çfarë cilësie të naftës kemi në Kosovë?

Berjani: Ne si shoqatë kemi qenë zë i fuqishëm që kontrolli i cilësisë së naftës të bëhet në kufi dhe deri më tani Dogana e Kosovës ka arritur ta kontrollojë cilësinë deri në 70 për qind dhe me këtë përqindje nuk jemi të kënaqur.

“Epoka e re”: A pritet të ketë lëvizje të çmimeve të derivateve?

Berjani: Sa i përket çmimeve, gjatë javës që shkoi ka pasur lëvizje të lehta të çmimit me shumicë, por tek ato me pakicë nuk ka pasur lëvizje të çmimeve.

“Epoka e re”: Gjatë kësaj jave pritet të ketë rritje të theksuar të derivateve të naftës?

Berjani: Vlen të theksoj se çmimet do të jenë deri në një euro. Për naftë çmimet pritet të jenë 0.99 centë, kurse për benzinë 1 euro.

“Epoka e re”: Si sillen çmimet e derivateve të naftës në Kosovë?

Berjani: Sa i përket çmimit të derivateve, qytetarët e Republikës së Kosovës janë duke u shërbyer me çmimet më të lira në regjion, përveç Maqedonisë së Veriut, e cila e ka akcizën më të ulët prej 0.22 centësh.

“Epoka e re”: Si sillen sot çmimet në Kosovë?

Berjani: Çmimet në Kosovë për naftë janë 0.95 centë, kurse për benzinë 0.96 centë. Kurse sot në Shqipëri çmimet janë: nafta 1 euro e 37 centë, ndërsa benzina 1 euro e 38 centë.

“Epoka e re”: Z. Berjani, cilat janë sfidat me të cilat përballet sektori i naftës në vendin tonë?

Berjani: Ky sektor ka shumë

Ndahen 10 milionë euro për rimëkëmbjen ekonomike të komunave

PRISHTINË, 24 GUSHT - Ministri i Pushtetit Lokal, Goran Rakiq, ka bërë me dije se do të ndahen 10 milionë euro për komunat për ta menaxhuar situatën e krijuar nga pandemia Covid-19. Në takim që kryeministri Avdullah Hoti ka pasur të hënën me kryetarët e komunave, ministri Rakiq ka prezantuar aktivitetet e MPL-së gjatë pandemisë si dhe planet për të ardhmen. Duke folur për ndihmën dhe përkrahjen për komunat, përveç shumë projekteve që janë në fazën e zbatimit, ministri ka theksuar projektet që zbatohen përmes skemës së granteve për performancë komunale, ku 4.9 milionë euro u ndanë nga MPL-ja dhe Qeveria e Zvicrës, Suedisë dhe Norvegjisë.

Më tej, ai ka theksuar rëndësinë e projekteve nga Programi për Zhvillimin e Infrastrukturës Socio-Ekonomike dhe Bashkëpunimit Ndërkomunal në vlerë prej 573 347 eurosh, si dhe projektin “Komuna për Rininë” i financuar nga Qeveria e Japonisë përmes Bankës Botërore në vlerë prej 3 milionësh.



Në fund të prezantimit të tij ministri ka folur për Planin e Qeverisë për Rimëkëmbjen Ekonomike. “Në lidhje me aktet e fundit të miratuara nga Qeveria, pra Vendimin për miratimin e Planit të Zbatimit të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike, ministria mori përsipër përgjegjësinë për zbatimin e detyrimeve nga ky proces. Në këtë drejtim, 10 milionë euro do të ndahen për komunat për ta menaxhuar situatën e krijuar nga pandemia Covid-19, si dhe 29 milionë euro për t'i mbështetur komunat. Për më tepër, në përputhje me kërkesën e Zyrës së Kryeministrit, ministria ka përgatitur propozime për projektion investimesh në projektet e infrastrukturës në nivelin lokal për periudhën pesëvjeçare 2021-2025, në vlerë prej 58,388,098.23 eurosh”, ka theksuar Rakiq.

Përfaqësues të OAK-ut dhe Kuçi diskutojnë për përkrahje të bizneseve

PRISHTINË, 24 GUSHT - Pako e rimëkëmbjes ekonomike, mungesa e ligjeve të harmonizuara me njëra-tjetrën dhe jofunksionale, taksat e dyfishta dhe Ligji për Investime Strategjike ishin disa prej temave kryesore të diskutimit në takim të realizuar nga përfaqësuesit e Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK) me ministrin e Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi dhe këshilltarët Muhamet Spahiu dhe Ramadan Gashi.

Anëtarë i bordit i kësaj ode, Hamdi Malushaj, ka theksuar



se momentalisht ka mungesë të harmonizimit të ligjeve. Ai ka thënë se OAK-u ka kërkuar nga qeveria të rritet Fondi për Garanci Kreditore, pasi kjo është kërkesë e bizneseve ashtu që të lehtësohet përkrahja e tyre për tejkalim të pandemisë.



KRU ‘Prishtina’ njofton për gjendjen e liqeneve në Batllavë e Badoc

PRISHTINË, 24 GUSHT - Kompania Rajonale e Ujësllësit “Prishtina” ka njoftuar lidhur me gjendjen e dy liqeneve akumuluese, atë të Batllavës dhe të Badocit. Sipas kompanisë, gjendja e tyre është në nivelin maksimal. “Liqenet akumuluese sipërfaqësore

Batllava dhe Badoci sot. Batllava me 631.57 metër mbi nivelin e detit ose 3.43 metër nën nivelin maksimal. Badocit me 640.60 metër mbi nivelin e detit ose 9.25 metër nën nivelin maksimal”, thuhet në njoftimin e KRU “Prishtina”.

Komuna e Mitrovicës bëhet gati për mbajtjen e provimit të maturës

MITROVICË, 24 GUSHT (ER) - Drejtuar nga kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, të hënën është mbajtur mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve, në të cilën janë diskutuar dhe shqyrtuar çështje të rëndësishme nga fushëveprimi i këtij bordi dhe drejtorive komunale. Fillimisht drejtori i Arsimit, Egzon Jashari, ka njoftuar ekzekutivin lidhur me përgatitjet e bëra për rihapjen e çerdhes publike "Gëzimi Ynë", duke thënë se, pas përgatitjeve të nevojshme, në përputhje me dokumentet zyrtare të institucioneve

kompetente shëndetësore, si dhe në bazë të kërkesave dhe rekomandimeve të pranuara, DKA-ja ka vendosur që nga sot të rifillojë puna në çerdhen publike. "Paraprakisht është bërë përgatitja e objektit, pajisja e personelit me librezë sanitare nga IKShPK-ja dhe bashkërisht me stafin e çerdhes kemi hartuar protokollin e veprimit të cilat specifikojnë organizimin e brendshëm, hallkën e komunikimit prind-fëmijë-edukatore si dhe veprimet konkrete përballë rasteve potenciale me CoVid-19", ka thënë Jashari.

Më tutje, ai ka përmendur edhe provimin e maturës shtetërore për vitin 2020, i cili do të mbahet më 29 gusht 2020 duke filluar nga ora 10:00 dhe do të zgjasë deri në orën 12:30. Ai ka thënë se testi do t'i ketë gjithsej 100 pyetje dhe përfshihen tri lëndë obliguese: Gjuhë Amtare, Gjuhë Angleze dhe Matematikë si dhe një lëndë zgjedhore e përzgjedhur nga vetë kandidati. Ndërsa në këtë mbledhje drejtori për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, Shukri Gashi, ka kërkuar nga drejtoritë që ta përgatisin listën me projektet prioritare të



investimeve kapitale të financuara nga granti dhe të njëjtat të procedohen fizikisht në Ministrinë e Financave në mënyrë që të bëhet alokimi i mjeteve.



Panorci i Malishevës bëhet me rrugë të asfaltuar

MALISHEVË, 24 GUSHT (ER) - Në fshatin Panroc të Malishevës ka filluar asfaltimi i rrugëve në disa lagje të fshatit. Asfaltimin e 250 metrave rrugë në këtë fshat të hënën e kanë parë drejtori komunal i Urbanizimit, Ahmet Morina dhe ai për Mbrojtje dhe Shpëtim, Hafir Rexha.

Drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit, Ahmet Morina, ka thënë se "gradualisht edhe në këtë fshat, sikur edhe në fshatrat e tjerë, asfaltimi i rrugëve brenda lagjeve po shkon drejt përfundimit dhe brenda pak muajve i tërë procesi i rregullimit të rrugëve nëpër lagje, në të

gjitha fshatrat, do të përfundojë". Sipas projektit, janë 250 metra rrugë brenda lagjeve dhe këto tani do të përfundojnë, për të vazhduar me vendbanimet e tjera. Asfaltimi i rrugëve në lagjet e fshatrave mundësohet nga buxheti i Komunës së Malishevës.

Komuna e Prishtinës ndihmon bletarët

PRISHTINË, 24 GUSHT (ER) - Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se ka bërë shpërndarjen e 800 koshereve për bletë për fermerët e kësaj komune. "Drejtorja e Bujqësisë në fshatin Mramor bëri shpërndarjen e 800 copë koshere bletësh, 100 centrifugë elektrike, 100 depozitorë mjalti prej 50 kg, 100 bluza bletari dhe 800 kuti ushqyese për

bletë për fermerët e Komunës së Prishtinës", ka njoftuar komuna që drejtohet nga Shpend Ahmeti. Sipas këtij njoftimi, nënkryetari i Prishtinës, Selim Pacolli dhe drejtori për Bujqësi, Shkumbin Gashi, kanë siguruar fermerët se përkrahja me pajisje, inpute dhe subvencione në të gjithë sektorët e bujqësisë do të vazhdojë edhe në të ardhmen.



'Zenel Hajdini' në Gjilan pranon donacion nga bashkatdhetarët nga Zvicra

GJILAN, 23 GUSHT (ER) - Gjimnazi "Zenel Hajdini" në Gjilan ka pranuar të hënën një donacion me mjete të konkretizimit nga bashkatdhetarët që jetojnë në Zvicër, Agon dhe Isuf Behluli, të cilët këtë hap e kanë ndërmarrë në kuadër të krijimit të kushteve më të mira të mësimdhënies në shkencat shoqërore. Me këtë rast, drejtori i Arsimit në Gjilan, Nazim Gagica, ka falënderuar donatorët për këtë mbështetje në kohë pandemie, ku këto mjete konkretizimi do të krijojnë kushte më të mira në mësimdhënien për nxënësit e kësaj shkolle. "Tavolinat e punës, karriget, pajisje të ndryshme teknologjike, laptopë,

kompjuterë dhe mjete të tjera të konkretizimit, janë vetëm disa nga mjetet që sot e pasurojnë gjimnazin shoqëror dhe mësimnxënien. Ky donacion, i cili është ndërmjetësuar nga sekretari Reshat Behluli, është një dëshmi e mirë e përkushtimit në punë të personelit të shkollës. Në bazë të asaj që kanë deklaruar Agoni dhe Isufi, ky është kontingjenti i parë, sepse në të ardhmen kemi premtime se do të marrim edhe donacione të tjera të kësaj fushe", ka thënë Gagica. Ndërsa në emër të Gjimnazit "Zenel Hajdini" ka folur drejtori Sami Hoxha, i cili ka konfirmuar se me këto mjete do të ndryshojnë shkolla dhe cilësia në mësim.



ZOTËRI DICK MARTY, KUR DO TË TURPËROHENI E KËRKONI FALJE PËR ATO QË KENI SHKRUAR? (35)



Shkruan: Kudusi LAMA

Aktualisht i vetmi klan që është bërë i pranishëm në trojet shqiptare është klani Dick Marty. Por as ai klan i rrezikshëm, megjithëse i dëmtoi mjaft shqiptarët, nuk i tremb as që ka për t'i trembur ndonjëherë. Por ju doni me çdo kusht t'i siguron informacionet që ju interesojnë sipas planit të akuzave e shpifjeve që keni programuar, për ta bërë raportin tuaj, prandaj edhe nuk përtoni të veproni duke regjistruar biseda nëpër tubime të ndryshme, nëpër dhoma ndenjeje e takime gjoja të rastit të personave të tretë, me njerëz që mund të jenë të prirë për të thënë gjëra nga më të ndryshmet, për të treguar se dinë diçka, prej të cilëve edhe mund të gjenden në vende të ndryshme. E njerëzit tuaj të tretë nuk di me çfarë shpërblimesh jua kanë sjellë incizimet që ju i quani me interes. Mua kjo ma kujton kohën e Titos e të Millosheviqit, sepse edhe ata për t'i dënuar ata që kishin dëshirë t'i dënonin, futnin pikërisht njerëz të tillë nëpër ndeje të ndryshme dhe sipas këtyre të dhënave portretizonin njerëzit e rrezikshëm që donin t'i çloronin trojet shqiptare të pushtuara dhe i dënonin. Mos mendoni se keni shpikur ndonjë metodë të re, kjo metodë është shumë e njohur për shqiptarët. Dhe ta dini se me metoda të tilla pushtuesi jugosllav e serb, ka pushkatuar, varur, masakruar e zhdukur me dhjetëra mijëra shqiptarë. A vërtet me këtë metodë mendon se do t'i dënosh shqiptarët? Ju zotëri bëheni qesharak kur merrni përgjegjësi të jeni i gjithanshëm e, mbi të gjitha, edhe korrespondent i luftës dhe ekspert ushtarak, duke dhënë definicionin në pikën 29, kur shpreheni: "... grupimet armiqësore rrallë janë ndeshur në luftime të armatosura përgjatë ndonjë vije frontale të çfarëdoshme". Nga i nxirrni këto zotëri? A nuk e dini se në Kosovë, Serbia ka pasur vetëm forca

tokësore 72 mijë ushtarë dhe policë, me të gjitha kapacitetet e armëve tokësore, shto këtu edhe helikopterët e shumtë dhe gjithë aviacionin gjuajtës - bombardues e, krahas këtyre, ka sjellë dhe ua ka shpërndarë 63 mijë armë civilëve serbë nëpër Kosovë, që t'i përdornin sipas organizimeve? Pa folur edhe për mbi 13 mijë paramilitarë e kriminelë të nxjerrë nga burgjet vetëm për të luftuar në Kosovë e ato qindra a ndoshta më shumë agjentë të UDB-së. Të gjitha këto forca pse ishin në Kosovë? Njëkohësisht po ju informoj se edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës në fuqinë maksimale të saj ka pasur rreth 60 mijë trupa luftëtarësh. Sipas jush, këto mbi 200 mijë njerëz të armatosur nuk janë marrë me asgjë. Jo zotëri gaboni. Për 20 muaj të luftës publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, gjithnjë janë zhvilluar luftime midis forcave të pushtuesit dhe çlirimtarëve, dhe gjithnjë janë zhvilluar beteja frontale. Në atë kohë lufte duhet të njiheni me zonat e çloruara nga UÇK-ja e në disa raste edhe të ripushtuara nga armiku, si mund të bëhen ndeshje luftarake pa përbalje frontale të forcave pjesëmarrëse në luftë? Keni mashtruar veten zotëri, ose ju intereson të vetëmashtroni ç'ka mund të jetë më e mundshme, por ju nuk e njihni as historinë shqiptare, as kombin shqiptar, ju kryet një mashtrim që ia vlejti dhe kaq. Në pikën 30 të raportit kaloni lehtë me deklarin: "*Dhunimet e urryera të bëra nga ushtarët dhe forcat e policisë serbe, që përpiqeshin të nënshtronin, dhe më pas të dëbonin popullsinë shqiptare të Kosovës, janë të njohura publikisht dhe të përcaktuara më se qartë*". Sa lehtë të shprehësh një gjenocid të pashembullt në historinë njerëzore, vetëm me dy radhë në një raport ndërkombëtar, duke e quajtur çështjen të përfunduar. Jo mor zotëri, ju nuk mund t'i imagjinoni krimet e dhunimet e bëra nga serbët në Kosovë dhe duhet të dini se do të duhet të kalojë aq kohë sa të largohen nga kjo botë edhe ata që kanë lindur prej dhunimeve, që të mund të flitet me gjuhën që flitni ju. Por ju, siç duket, ju është fikur çelësi i ndjenjave njerëzore dhe qytetarinë e kulturën kombëtare dhe shoqërore i konsideroni thjesht një element zburimori.

Duke lexuar raportin tuaj, mua që e njoh mirë situatën e kohës së luftës dhe i njoh mirë shumë prej luftëtarëve e komandantëve të Luftës Çlirimtare të Kosovës, më mbushet gjoksi me mllef për shëmtinë me të cilën shpreheni, por unë do të përiquem të qëndroj sa të mundem i qetë në vlerësimet e mia për këtë raport, pasi e kam kuptuar plotësisht se ju jeni vetëm ai që e keni firmosur dhe nuk keni vënë asnjë germë në të me lapsin tuaj. Ky vërtet është me informacione që unë i njoh që prej Millosheviqit. Por kurrë nuk më kishte shkuar mendja se mund të gjendej dikush në Evropë që të servite informacione të tilla e aq më shumë për organizata të tilla madhore botërore, siç është Këshilli i Evropës. Në pikën 31 ju keni zbuluar prova që janë në kontradiktë me "*...me pamjen joshëse të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, paraqitur si një ushtri guerrilasish që kanë luftuar trimërisht për të mbrojtur të drejtën e bashkëpatriotëve të tyre për të jetuar në territorin e Kosovës*". Nuk di si keni kaq guxim sa të njollosni një ushtri çlirimtare të një populli, lavdinë e një kombi, këtë përveç serbëve deri tani nuk e ka bërë askush veç jush. Si mund të tentoni të quani jo të vërtetë një ushtri të tërë? Vërtet duhet të jeni paguar rëndë për këtë që keni shkruar, nëse e keni shkruar. Ndërsa në pikën 32 shpreheni: "*Nëse është e pamohueshme se shumë ushtarë të guximshëm, të gatshëm për të shkruar në luftë e për t'i bërë ballë kundërshtarit, për të vdekur, në rast nevojë, për kauzën e një atdheu kosovar shqiptar të pavarur, ishin të pranishëm në radhët e UÇK-së, përsëri këta nuk përbënin detyrimisht shumicën*". Pra, sipas jush, shumica çfarë ishin? Apo siç shpreheni edhe më parë "ekzekutues të thjeshtë të klanit". Zotëri ata djem e vasha me armë që përbënin Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, doni apo nuk doni ju, ishin 100 për qind atdhetar të gatshëm për të dhënë jetën për çlirimin e atdheut e kombit të tyre shqiptar. Ata për asnjë moment nuk kanë menduar se cilat do të ishin përfitimet e tyre të të nesërme, se nuk kishin kohë për t'u marrë me këto llogari. Ata ishin të gjithë luftëtarë të guximshëm dhe pa asnjëlloj

mëdyshje për t'u përbalhur me armikun e dhënë jetën. Asnjë luftëtar dhe drejtues i kësaj ushtrie çlirimtare përveç shporrjes me çdo kusht të pushtuesit nuk ka pasur asnjë lloj ambicie për pas luftës, pasi unë i njoh mirë dhe i di synimet e tyre, pavarësisht si shpreheni ju në pikën 33 të raportit. Por në këtë moment më kujtuat një episod të vitit 1998, kur unë në ushtrim të detyrës time si komandant i zonës së veriut të Shqipërisë, duke parë rrjedhën e ngjarjeve, bëja takime me strukturat e qeverisjes lokale dhe kryefamiljarët në rajone të ndryshme të zonës, sipas një plani të caktuar. Por një ditë pas një takimi në një komunë një fshatar vëreja se kërkonte të më takonte, por ata që më shoqëronin po e pengonin. Për këtë e pyeta kryetarin e komunës, se çfarë kishte fshatari, kur ai më tha se donte të më takonte mua, kërkova të mos e pengojnë. Kur fshatari erdhi tek unë dhe u përshëndetëm, e pyeta çfarë halli kishte. Ai më tha: - Me sa kuptova unë ju do të bëni luftë, se Serbia mund të ketë dëshirë të zgjerojë luftën për të futur në hije Kosovën. E po u bë luftë, unë e di se ju do të ma shkatërroni shtëpinë, se e kam në afërsi të kufirit. Prandaj unë kërkoi nga ju që të më jepni një shkresë me firmën tuaj, që po të më prishet shtëpia, të ma paguani pas luftës. Unë pasi e dëgjova, jo pa habi, iu përgjigja: - Unë po lumturohem që ju e ditkeni se pas luftës do të jeni gjallë. Sepse unë e di saktë se pas luftës nuk do të jem gjallë, pasi me siguri do të vritem në luftë. Prandaj meqë unë nuk do të jem pas luftës, ju mund ta merrni vërtetimin tek ai që do të ketë fatin të jetë në vendin tim, kur të bëhet paqe. Fshatari zotëri Marty u turpërua për kërkesën e tij, kërkoi shumë falje dhe u largua. Dhe të them sinqerisht, unë e kisha shumë seriozisht, dhe kisha bindje të plotë, në ato fjalë që i thash fshatarit. Kaq kanë menduar edhe të gjithë luftëtarët dhe drejtuesit e UÇK-së. Prandaj unë bëj pyetjen për ju zotëri Marty, ju kur do të turpëroheni e kërkoni falje për këto që keni shkruar, e të ngjiteni të paktën deri në nivelin e atij fshatarit që iu tregova? Por prapë nuk besoj se ju jeni i prirë për t'u turpëruar,

pasi nuk ngjiteni dot në nivelin e fshatarit shqiptar. Sepse ju edhe informacionin që jepte UÇK-ja gjatë luftës, në pikën 34 e quani mashtrim. Ju arrini deri atje, sa në pikën 35, tregoni pa far mëdyshje se ata komandant e drejtues të UÇK-së, që nuk kishin automjete, por edhe furnizimin e fronteve me armatim e municione e bënin me shpinë ose me kafshë, paskan menduar të përfitojnë nga sektori i naftës, ndërtime, qiradhënia, etj, që seriozisht, duke lexuar raportin tuaj po më dhemb krejt trupi, pasi po më duket i turpshëm për vete edhe akti i leximit, pasi po më duket se po bëhem bashkëpunëtor më ju në këtë ndërmarrje të paskrupullt. O njeri, po a mund të shkruhet kështu: "*Një numër i madh prej tyre do jenë përpjekur të përfitonin sa më shumë nga pushteti që kishin gjatë kohës kur disa zona jashtë ligji ishin vendosur nën autoritetin e tyre veprues (si në disa pjesë të Kosovës jugore dhe perëndimore) dhe të përdornin ndikimin e tyre, sidomos për sa i përket burimeve financiare, për t'u vendosur në vende të tjera (për shembull në Shqipëri)*". Po ku kishte financa në Kosovë në atë kohë lufte? Ku mund të merreshin paratë në Kosovë? A nuk e dini se UÇK-ja ka pasur një strukturë të veçantë që është quajtur fondi "Vendlindja Thërret", strukturë e cila ka vepruar në të gjitha kontinentet, duke grumbulluar fonde nga diaspora për të financuar luftën? Po pse more nuk ulesh me këmbë në tokë o njeri e të kuptosh se çdo të thotë luftë e organizuar nën pushtim? Po ata djem që kalonin me shërbim në Shqipëri, po t'i ndaloje dhunshëm një ditë më shumë se nevoja e shërbimit, qanin si fëmijë pse po pengoheshin të shkonin tek bashkëluftëtarët e tjerë në vijat e fronteve, ku kishin kohë ata të siguronin fonde për t'u vendosur në Shqipëri? Jo zotëri, ata nuk kishin pse vendoseshin në Shqipëri, ata do të luftonin dhe për ta do të kishte ose çlirim të atdheut, ose rënie në frontin e luftës për liri. Nuk kishte asnjë alternativë tjetër dhe këto dy alternativa ia kishin caktuar vetvetes, askush nuk kishte marrë vendim për ta. (Vijon)

Në 22-vjetorin e rënies së Ismet Jasharit - komandant "Kumanova"

Luftëtar i paepur i çështjes kombëtare

Nga Doc. dr. Minir ADEMI & profesor Selajdin SHABANI

Më 25 gusht të këtij viti bëhen 22 vjet nga rënia heroike e njërit prej figurave më të rëndësishme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, Ismet Jashari. Ai e deshi më shumë se gjithçka lirinë, e deshi më shumë se gjithçka atdheun dhe ishte ndër të parët që iu përgjigj kushtrimit për luftë, pa kursyer as jetën. Në këtë përvjetor ai meriton më shumë se kurrë të përkujtohet. Jetëshkrimi dhe biografia e tij janë dhe do të mbeten udhërrëfyese dhe shembuj për gjeneratat e ardhshme, se si njeriu përkushtohet për çështjen kombëtare. Andaj në këtë shkrim dhe këtë përvjetor, ne vetëm rikujtojmë veprimtarinë e tij në mënyrë simbolike.

Ismeti lindi në fshatin Orizare të Komunës së Likovës - Kumanovës - më 16 prill 1967. Ishte i biri i Jashar dhe Nurie Jasharit. Ismeti rrjedh nga një familje me vlera atdhetare. Dy vëllezërit e tij më të mëdhenj, Xhemajli dhe Murati, vazhdimisht zhvillorin veprimtari atdhetare, të cilët edhe kishin ndikuar në formimin e personalitetit të Ismetit. Ata kishin mbështetur hapur kërkesat e bashkëkombësve në Kosovë, të shprehura në demonstratat e mars-prillit të vitit 1981 dhe për këtë ishin arrestuar dhe dënuar nga regjimi i atëhershëm jugosllav. Pasi mori mësimet e para në shkollën fillore të vendlindjes, Ismet Jashari u regjistrua në Shkollën e Mesme Artizanale Ekonomike "Pero Nakov" të Kumanovës në vitin 1982. Por, për shkak se ishte nga një familje nacionaliste, organet e pushtetit të atëhershëm shtetëror jugosllav ushtruan presion të vazhdueshëm mbi të, që e detyroi t'i ndërpriste mësimet dhe të vazhdonte në gjimnazin e Preshevës. Gjatë kohës sa ishte nxënës i shkollës së mesme ai u inkadrua në Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës. Për shkak të ndjekjeve dhe presionit të vazhdueshëm të pushtetit jugosllav, ashtu si shumë veprimtarë të tjerë të çështjes kombëtare, edhe Ismet Jashari detyrohet të emigrojë në Zvicër. Edhe aty nuk e ndali aktivitetin dhe angazhimin atdhetar. Asokohe ishte në kontakt të vazhdueshëm me vëllezërit e tij, Muratin e Xhemajlin, si dhe me shumë bashkëveprimtarë të tyre të cilët zhvillorin aktivitetin çlirimtar. Jo vetëm në Zvicër, por edhe në vende të tjera evropiane ai mori pjesë në shumë organizime, tubime, demonstrata të ndryshme në mbështetje të çështjes kombëtare.

Ismeti i takon brezit përkushtues atdhetar, i cili gjithmonë veprimi në mbështetje të idesë për t'iu kundërvënë me forcë pushtuesit. Ai, së bashku me veprimtarët e tjerë, nuk reshti kurrë në angazhimin e tij atdhetar për krijimin e kushteve për luftë të armatosur kundër pushtuesve të trojeve etnike.

Ismeti ishte ndër të parët që mori pjesë në themelimin e fondit "Vendlindja thërret", i cili u bë bazë kryesore e logjistikës dhe e financimit të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Gjithashtu, menjëherë pasi filluan luftimet midis UÇK-së dhe ushtrisë e policisë serbe, ai vendosi që të shkonte në Kosovë për të marrë pjesë drejtpërdrejt në frontin e luftës.

Pas ngjarjes epokale të Prekazit, të 5, 6 dhe 7 marsit të vitit 1998, atdhetari i përkushtuar i luftës çlirimtare, Ismet Jashari, nuk kishte hamendje që t'i fillonte përgatitjet për të hyrë në Kosovë. Kështu, më 11 mars 1998, ai, bashkë me Fehmi e Xhevë Lladrovcin, Mirush Dakën, Bekim Berishën, Agim Bajramin, Fatmir Limajn, Haxhi Shalën e të tjerë, futet në zonat ku po vepron Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe vendoset në Likoc të Drenicës, ku asokohe ndodhej baza më e rëndësishme e saj. Me vendim të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Ismet Jashari u ngarkua me detyrë ushtarake në zonën e Llapushës, me qëllim të zgjerimit dhe konsolidimit të radhëve të Ushtrisë Çlirimtare. Që në mars të vitit 1998, Ismet Jashari me bashkëluftëtarët e tij: Fatmir Limajn, Haxhi Shalën, Sadik Shalën e të tjerë, formojnë njësitin ushtarak "Çeliku", me bazë në fshatin Kleçkë. Që në fillim të përfshirjes së tij në luftën e Kosovës, për shkak të konspiracionit,

Ismetin, bashkëluftëtarët e thërrisnin me emrin Kumanova. Ismeti me bashkëveprimtarët e tij ishin luftëtarë e lirisë që rrezatonin shpresë dhe frymëzim për popullatën civile të gjithë ushtarët. Në prill të vitit 1998 Ismet Jashari, i ngarkuar me detyrë ushtarake, ndodhej në Dukagjin. Gjatë kthimit për në Kleçkë ra në pusi të forcave serbe, te vendi i quajtur "Guri i Zi", në mes të fshatrave Volljakë e Çupevë të Klinës. Këtu, ai plagoset në të dyja këmbët. Kur luftëtarët e lirisë arritën ta merrnin nën kontrollin e tyre grykën legjendare të Llapushnikut, më 9 maj të vitit 1998 Ismet Jashari, ende pa u shëruar sa duhet, mori pjesë aktive në barrikadimin e kësaj gryke, e cila u bë barrierë e pathyeshme për forcat armike deri më 27 korrik të po atij viti. Pas marrjes së asaj pike tejet të



rëndësishme strategjike, Ismet Jashari me bashkëluftëtarët i afrohet pikave të tjera po aq me rëndësi: në Qafë të Dulës dhe në Grykë të Carralevës. Prej fillimit të majit e deri në mbarim të gushtit të vitit 1998, Ismet Jashari - komandant "Kumanova", Fatmir Limaj - komandant "Çeliku", Haxhi Shala - komandant "Topi", Shukri Buja - komandant "Sokoli" e shumë luftëtarë të tjerë të dalluar, përforcuan të gjitha pikat ushtarake në pjesën jugore të Drenicës, duke filluar nga Llapushniku e deri në Qafë të Dulës, prej Arllatit e deri në Bllacë dhe prej Komoranit e deri në Blinajë. Në ofensivën e forcave pushtuese serbe të 25 dhe 26 korrikut të vitit 1998, në Grykë të Llapushnikut dhe në fshatin Zborc afër Grykës së Carralevës, Ismet Jashari me bashkëluftëtarët e tij: Imer Alushani, Gani Kastrati, Nuhi Mazreku, Ali Zogaj, Habib Zogaj e shumë të tjerë, luftuan e qëndruan heroikisht në mbrojtje të pozicioneve ushtarake të UÇK-së. Heroizmi i tij në fushëbeteja bëri që emri i komandant "Kumanovës" asokohe të bëhej burim frymëzimi për luftëtarët e lirisë dhe sinonim i fitores jo vetëm në Drenicë e Llapushë, por në mbarë Kosovën.

Fakti se në luftën e lavdishme për çlirimin e Kosovës luftonin edhe luftëtarë nga trojet shqiptare në Maqedoni, përforconte jo vetëm moralin e ushtarëve por, njëkohësisht, i jepte shpresë popullatës civile (e cila, për të mbijetuar nga granatimet serbe, kishte gjetur strehë në pyje e në gryka malesh), se dita e çlirimit të

tokës së Kosovës do të ishte e shpejtë. Më 23 gusht të vitit 1998, pasi ushtria serbe kishte ndërmarrë të gjitha masat për të depërtuar në drejtim të Kleçkës, ku ndodhej edhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Ismet Jashari organizon rezistencën në pikën e tij të pamposhtur, në Bajrak të Luzhnicës. Atë ditë forcat serbe kishin granatuar me të gjitha llojet e armëve të rënda të artilerisë pozicionet e komandant Kumanovës, i cili printe në ballë të kundërsulmit mbi forcat armike. Në mbrojtje të pozicioneve ishin rreshtuar luftëtarët më të dëshmuar, meqë pika ku armiku bënte përpjekje për të depërtuar në drejtim të Kleçkës ishte me shumë rëndësi për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Në të njëjtën kohë, forcat serbe kishin sulmuar edhe në drejtim të Tërpezës, të Bllacës e të pikave të tjera përreth Kleçkës. Më 24 gusht 1998 forcat pushtuese serbe kishin shtuar valën e sulmit duke gjuajtur me arsenal të llojllojshëm luftarak, me topa të kalibrave të mëdhenj dhe me raketa tok-tok. Pika ushtarake në Bajrak nuk po binte, ndonëse bunkerët po digjeshin. Në mbrëmje luftëtarët e lirisë kishin depërtuar thellë në pozicionet armike, duke u shkakuar dëme në njerëz dhe në teknikë luftarake, mirëpo bashkëluftëtarët e Ismetit, Gani Kastrati dhe Afrim Buçaj, nuk kishin arritur të tërhiqeshin. Gjatë mëngjesit të 25 gushtit 1998 Ismet Jashari kishte kundërsulmuar befasishëm, në përpjekje për t'i marrë trupat e ushtarëve të rënë. Pas disa orë luftimesh, në një distancë të afërt me forcat serbe,

në altarin e atdheut, në Luzhnicë, ra dëshmor një ndër luftëtarët më të dalluar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Ismet Jashari, komandant "Kumanova". Bashkë me atë ranë dëshmorë edhe Nuhi Mazreku dhe Habib Zogaj. Më pas, bashkëluftëtarët e komandant Kumanovës ndërmarrin një aksion në afërsi të fshatit Shirokë të Therandës, nga ku arrijnë t'i tërheqin trupat e pesë dëshmorëve, të cilët i varrosin me nderime ushtarake në Kleçkë. Këta trupa forcat armike i kishin dërguar në Shirokë, në përpjekje për t'ua humbur gjurmët. Sot trupi i dëshmorit Ismet Jashari prehet në kompleksin e Varrezave të Dëshmorëve në Kleçkë, ku pushojnë edhe trupat e dëshmorëve të tjerë, të Brigadës 121 "Ismet Jashari-Kumanova". Për kontributin e jashtëzakonshëm që dha në luftën për çlirimin e Kosovës, më 25 gusht të vitit 2009 Presidenti i Republikës së Kosovës, Fatmir Sejdiu, e dekoroi Ismet Jasharin me Urdhërin "Hero i Kosovës". Në shenjë mirënjohjeje për përjetësimin e veprës heroike të Ismet Jasharit - komandant "Kumanovës", atij i ngritën shtatoren afër Shtëpisë-Muze të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe në Orizare. Edhe në Komunën e Likovës, në shenjë respekti, shkolla e mesme mban emrin e tij. Sot në këtë përvjetor të rënies heroike të 22-të, edhe pse të heshtur, ai mbetet në zemrat e popullit që përkujtohet vazhdimisht si një pishtar i lirisë që nuk kurseu as jetën për të mirën e kombit. Andaj, kujtimi për veprimtarinë e tij mbetet i pavdekshëm kurdoherë!

RAHMAN DINI FIGURE E MADHE ATDHETARE

Nderim e respekt për komandantin e UÇK-së, të pavdekshmin Rrahman Dini



Ismet SYLEJMANI

KUJTIME NGA KOHA E LUFTËS

Më 29 Qërshor 2020 në optika Simoni në Prishtinë, me të nderuarën Rreze Dinin ishte një takim i imi jo vetëm i papritur, por edhe i cili do të mbetet i pashlyer në memorien time, sepse do të shënohet si një ngjarje personale që më mbërtheu dhe nuk më lëshoi dot pa derdhur lot nderimi e respekti, krenarie e kujtimi përgjithmonë, për një atdhetar e patriot të madh, veprimtar e luftëtar me armë në dorë për çlirimin e Kosovës nga Serbia pushtuese!

Në mes të muajit maj të vitit 1999, në shtëpinë bazë të UÇK-së të Naman Nezirit në Gadish e me vone ne lagjen e UÇK-së të Dubovëve në shtëpinë bazë të ushtarit e komandantit të UÇK-së Naser Hajdari-Bekës, por edhe të ushtarit tjetër të kusheririt të tij Ismet Hajdari, ka qëndruar për disa ditë atdhetari i madh e veprimtari i shquar, ish i burgosuri politik, ushtari i orëve të para e komandanti i UÇK-së, i pavdekshmi Rrahman Dini, i shoqëruar nga bashkëluftëtari i tij, ushtari e komandanti, mjeku i UÇK-së nga Dukagjini, sot Specialist-Ortoped Traumatolog Mr. sci. Dr. Qerim Kida!

Pas përfundimit të ofanzivave të ushtrisë e policisë pushtuese serbe të njohura si betejat e Zhegocit e Marecit, në Zonën Operative të Karadakut rifilloi organizimi i luftës së armatosur çlirimtare dhe konsolidimi ushtarak i zonës!

Në kushtet e rikthimit dhe rivedosjes së sërishme në rrethinat e Malesisë së Zhegocit, aty ku ishte selia e Shtabit të Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së, kur ende nuk kishim vend dhe adresë të sigurtë, sepse ishte luftë dhe meqë ishim dëmtuar shumë nga dy ofanzivat e mëdha, kishim shumë pengesa e shumë vështirësi!

Në ato kohë kur pothuaj ishim percaktuar që në aspektin strategjik, të vendosnim selinë e Shtabit të ZOK në lagjen Sërpka të Kishnapoles që ishte në trekëndshin Kishnapole, Gadish dhe Plitkoviq, dhe afër lagjës së

Dubovëve, njëra nga bazat e sigurtat të Shtabit të Zonës së Karadakut, sepse ajo ishte edhe vendlindja dhe aty e kishte shtëpinë e Tij, njëri prej shokëve e bashkëluftëtarëve të mij më të mirë e më të sigurtë Naser Hajdari -Beka, ndër kohë që shumica e shtëpive të këtyre fshatrave ishin të djegur, të vjedhura e të dëmtuara nga eskadronet e vdekjes dhe bandat militare e paramilitare serbe, u gjendëm përpara një sfide të madhe lufte çlirimtare!

Ushtari më i ri në moshë i UÇK-së nga Verbica e Zhegocit, me vone edhe ushtarë i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare i rënë heroikisht në luftën titanike të popullit shqiptar në Sllupçan të Kumanovës në Maqedoninë e Veriut, Heroi i Kombit Shefik Miftari, vjen dhe na thot se nga Komandanti i Zonës Ahmet Isufi dhe zv. Komandanti Shemsi Sylja është derguar ky njeri, pra ishte fjala për ushtarakun e lartë të UÇK-së e oficerin madhor të Zonës Operative të Llapit, të shoqëruar nga mjeku i tij personal, Dr. Qerim Kida!

Më sollën një letër që ma kishin derguar përmes ushtarit Shefik Miftari, nga Komandanti e zv. Komandanti të ZOK-ut, dhe aty ne leter ishin të gjitha informacionet në detaje se kush ishte personi dhe një biografi e shkurtër e tij.

Ushtaraku Rrahman Dini i shoqëruar nga mjeku Dr. Qerim Kida kishin udhëtuar me një kali nga Zona Operative e Llapit për në teritorin e Zonës Operative të Karadakut e deri në Gadish, sepse Rrahmani ishte i smuar dhe kishte vështirësi edhe në ecje!

Dërgimi i Rrahman Dinit në spital në Gjilan u bë i pamundur për shkak të arrestimeve të mjekëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës! Pas disa orvatjeve tjera Rahmani bashk me Dr. Qerimin, u vendos të kthehen në Zonën Operative të Llapit që të ishin më afër Prishtinës pasi aty mundësitë ishin më të mëdha për hyrje në qendren spitalore!

RRËFIMI I RRAHMAN DINIT, PËR HEROIN E KOMBIT REXHEP MALAJ

Mbaj mend se gjatë kohës kur qëndronim bashk dhe prisnim lajme nga ushtarët që i kishim dërguar në Gjilan për të vënë kontakt me mjekët e UÇK-së, Rrahman Dini ma rrefeu një ngjarje shumë mbresëlënëse gjatë kohës sa kishte vuajtur nëpër burgjet e pushtuesve serb në Kosovë dhe nëpër ish-



jugosllavi!

Një transferim kur ia kishin bërë, nga një burg në tjetrin, Rahman Dini e paskan derguar në burgun e Foçës!

Kur paska hyrë në dhomën e burgut pasi ia kanë mbyllur derën gardianët shpirtëzinj me rrapllimë, është përshëndetur me të burgosurit që i ka gjetur në dhomë, dhe njëri nga të burgosurit e ka pyetur si e ke emrin, çfarë nacionaliteti e prej nga je? Rrahmani i tregon dhe ai me shpejtësi i thot, shko te ai krevati aty në ballë të dhomës, se aty ka qëndruar për vite të tëra një vella e shok i yti e një shqiptar i madh dhe shumë trim e i panështruar!

Kush ka qene ai, thoshte se e pyetur Rrahmani, ai i pergjigjet se ka qenë Rexhep Malaj! Rrahmani tha ashtu ne këmbë

sikur isha, duke i vendosur valixhet, i tregova se Rexhep Malaj policia serbe e ka vlarë në Prishtinë!

I burgosuri kroat (Dr. Nikolla Novakoviq, i cili ishte udhëheqës i Partisë Fshatare Kroate në B dhe H deri në vitin 1948, kaloi në klandestinitet deri në vitin 1974 kur burgoset dhe denohet me 12 vite burg), kur ky edhe filloi të qante, në dhomë u bë rrëmujë, erdhën gardianet, na morrën ne pyetje për çfarë po ndodhte! I burgosuri e thirri përgjegjësën e finansave të burgut që i kishte e secilit të burgosur, dhe i tha prerë, ndajë për mua vetëm pjesën e domosdoshme të mirëmbajtjes sime personale, dhe të gjitha tjerat na sjell ushqime e ëmbëlsira dhe pije! Neve na deklaroi se hapë ngushllimet dhe tha se dua të ju pres në

ngushllime ne nderim e për shpirt të të pamposhturit Rexhep Malaj!

I burgosuri kroat shoku i tij i burgut, tërë kohën qau në dhomë për vrasjen e Rexhep Malaj!

Kjo ngjarje e madhe për çelikon e burgjeve, të madhin e lavdishëm Heroin e Kombit Reshep Malaj, u bë ngjarje historike të cilën e solli në Atdhe i pavdekshmi Rrahman Dini, e cila kudo ku jetojnë e veprojnë shqiptarët patriot e atdhetarë, u bë e njohur dhe u tregua gojë me gojë!

Lavdi e perjetshme të pavdekshmit Rrahman Dini!

*Ish-shef per informim i Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së!
Ismet Sylejmani,
Prishtinë, 23 Gusht 2020!*

E jashtëzakonshme

Amerikanët lëshojnë 750 milionë mushkonja të modifikuara në natyrë

Autoritetet lokale të Florida Keys, pas një dekade, kanë aprovuar një plan për lirim të 750 milionë mushkonjave të modifikuara gjenetiksht, pavarësisht prej kundërshtimeve nga shumë vendës dhe një koalicion i grupeve të mbrojtjes së mjedisit, raporton "CNN". Ky projekt-pilot është krijuar për të provuar nëse një mushkonjë e modifikuar gjenetiksht mund të jetë një alternativë e suksesshme për spërkatjen e insekticideve. Llojet e mushkonjave "aedes aegypti" që banojnë në Florida transmetojnë disa sëmundje infektive vdekjeprurëse si zika, ethet e dengos, chikungunya dhe ethet e verdha. Në fillim të vitit 2021 mushkonjat do të lëshohen në Teksas,



kanë thënë nga "Oxitec", një kompani britanike me qendër në ShBA që ka zhvilluar mushkonjat e modifikuara gjenetiksht. Mushkonjat e modifikuara gjenetiksht janë testuar në

ishujt Kajman, Panama dhe Brazil dhe firma ka raportuar sukses të madh. Në pjesën urbane të Brazilit numri i mushkonjave ka rënë për 95 për qind, kanë thënë shkencëtarët.

BARSOLETA E DITËS



Mësuesja: Ti Astrit fle gjithë orën e mësimit. Kur dhe ku do të mësosh?
Astriti: Në ëndërr po shikoja pikërisht një orë mësimi, mësuese!



Në Kino ABC nuk ka shfaqje



E rrallë

Asteroidi që ka gjasa ta godasë Tokën, afrohet një ditë para zgjedhjeve në ShBA

Qendra për Studime të Objekteve në Afërsi të Tokës (CNEOS) nga laboratorit i NASA-s ka parashikuar se një asteroid do të kalojë pranë Tokës një ditë para zgjedhjeve presidenciale të ShBA-së, respektivisht më 2 nëntor, shkruajnë mediat amerikane. Diametri i tij është 0.002 km, sipas të dhënave të NASA-s. NASA ka thënë se ai mund të godasë në tri vende,

por "bazuar në 21 vrojtime që zgjasin 12 968 ditë", nuk mendon se mund ta dëmtojë rëndë planetin. Shkencëtarët kanë sugjeruar se nëse asteroidi hyn në orbitë do të ndahej gjatë hyrjes dhe do të krijonte meteor të ndritshëm. Asteroidi, për shkak të madhësisë së tij të vogël, nuk konsiderohet një "objekt potencialisht i rrezikshëm" nga metrikat e agjencisë hapësinore amerikane.

FOTO E DITES



Rruga e re i ka dhënë Deçanit një pamje të bukur

 <p>DASHI Gjatë kësaj dite do të jeni kureshtar dhe i gatshëm për të provuar gjëra të reja. Nëse keni një lidhje, duhet ta mbronni me çdo kusht.</p>	 <p>DEMI Shumë mund të mundohen, por askush nuk do t'ia dalë t'ua destabilizojë jetën gjatë kësaj dite. Për ju të dashuruarit nuk do të ketë asnjë lloj problemi.</p>	 <p>BINJAKËT Përkujdeseni më tepër për partnerin, t'ia shprehni ndjenjat atij dhe t'i përgatisni edhe ndonjë surprizë mbresëlënëse.</p>	 <p>GAFORRJA Nëse i dëgjoni këshillat që do t'ju japin të tjerët do të dilni të fituar sot. Tregohuni edhe sa më realist.</p>	 <p>LUANI Nëse keni një lidhje dhe doni që të kaloni çaste të këndshme me partnerin tuaj, mundohuni t'i vini kapak së shkuarës dhe të mendoni vetëm për të ardhmen.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Nuk duhet të lini asnjë mundësi t'ju ikë nga duart. Në punë do të keni mosmarrëveshje të shumta me disa kolegë që do të përpiqen t'ju bllokojnë rrugën për të ecur përpara.</p>
 <p>PESHORJA Çdo gjë do të ecë si duhet. Financat nuk do të jenë të këqija, por rekomandohet të mos jepni para hua sepse shumë shpejt do t'ju nevojiten më tepër për vete.</p>	 <p>AKREPI E mira është që t'i pranoni ato dhe të bëni të pamundurën për t'i zgjidhur. Sa më shumë të vonoheni për këtë gjë aq më keq do të jetë.</p>	 <p>SHIGJETARI Në punë duhet t'i mbronni me çdo kusht të drejtat tuaja dhe nuk duhet t'i lejoni kolegët t'ju prishin harmoninë.</p>	 <p>BRICJAPI Dijeni se askush nuk ka gjithë kohës një jetë të lumtur, prandaj mos u tregoni gjithmonë i pakënaqur.</p>	 <p>UJORI Në punë do t'ju kërkohen disa gjëra me urgjencë dhe pavarësisht ankthit dhe merakut, do t'i mbaroni në kohë. Financat do të fillojnë dalëngadalë të përmirësohen.</p>	 <p>PESHQIT Fillimisht gjërat do t'ju duken të ndërlikuara, por pak nga pak gjithçka do të kalojë në normalitet.</p>


Ardian Bujupi paralajmëron këngën e re



Këngëtari Ardian Bujupi vetëm pak javë më parë ka publikuar projektin e tij muzikor në bashkëpunim me Xhensila Myrtezaj. "Panorama" ka rezultuar një sukses i vërtetë dhe është kthyer në një nga hitet e kësaj vere. Por, Ardiani nuk ka


ndërmend të ndalet, pasi përmes një postimi në "Instagram" ka bërë me dije se do të sjellë shumë shpejt një projekt të ri muzikor. Këngëtari ka publikuar një video në "Instagram", duke na njohur me këngën e re që ka ardhur si një surprizë për fansat.

Paris Hilton jep detaje për abuzimin fizik dhe mental gjatë fëmijërisë



Paris Hiltoni ka shokuar audiencën përmes një tregimi që ka bërë rreth vështirësive në jetën e saj. Në dokumentarin "This is Paris" ajo ka treguar rreth abuzimit fizik dhe mental gjatë fëmijërisë, shkruan "Daily Mail". Rrëfimi i tillë rreth jetës së saj është i qasshëm në platformën digjitale "YouTube", ku Parisi ka treguar për abuzimet që i janë bërë në shkollën Provo Canyon në Utah. 39-vjeçarja ndër të tjera kishte shtuar për "People": "E var-

rosa të vërtetën time për një kohë të gjatë. Por, jam krenare se si kam arritur të bëhem një grua e fortë. Njerëzit mund të spekulojnë gjithçka për jetën time, por dua t'i tregoj botës se kush jam me të vërtetë". Ajo ka kaluar rreth 11 muaj në po të njëjtën shkollë, deri kur prindërit e saj filluan t'i shohin problemet e saj mendore. "Ata kanë qenë duke abuzuar me mua fizikisht. Dëshironin që ta fusnin frikën te fëmijët", ka thënë Parisi.



Lady Gaga surprizon ndjekësit me "look"-un e saj

Këngëtarja Lady Gaga ka ndarë së fundmi në rrjetin social "Instagram" një "selfie", ku është shfaqur natyrale, e veshur me një bluzë ngjyrë rozë dhe syzet e diellit dhe pa asnjë "makeup" në fytyrën e saj. "Ju dërgoj


dashuri, më mungoni dhe mezi po pres të performoj për ju", ka shkruar Gaga, ku nuk kanë munguar komplimentet nga fansat e saj, të cilët kanë vënë në dukje faktin se këngëtarja është shfaqur mjaft natyrale.

Këngëtari shqiptar i propozon martesë aktorese turke



Këngëtari shqiptar Bertan Asllani prej një kohe të gjatë është duke zhvilluar një karrierë të gjatë në Turqi. Ai ka marrë pjesë në serialin turk "Pis Yedili", bashkë me aktoren

Hazal Senel, me të cilën ka nisur edhe një histori dashurie. Lidhja e tyre duket se tashmë ka kaluar në një tjetër nivel, pasi këngëtari i ka propozuar martesë aktorese turke.



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Shtyhet fillimi i edicionit të ri në basketboll

“Bordi i FBK-së ka marrë vendim që ta shtyjë fillimin e edicionit të ri për një muaj, më saktësisht që edicioni i ri të fillojë më 14.10.2020, kur edhe do të organizohen ndeshjet e Superkupës së Kosovës”, thuhet në njoftimin e FBK-së

PRISHTINË, 24 GUSHT - Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), duke i parë zhvillimet e fundit me pandeminë Covid-19, në bazë të kompetencave të veta statutare, unanimisht të hënën ka marrë vendim që ta shtyjë fillimin e edicionit të ri në basketboll 2020/21.

Edicioni i ri në basketboll ka qenë i programuar të fillojë më 16.09.2020 me ndeshjet e Superkupës së Kosovës në të dyja konkurrencat dhe më pas të vazhdojë garat e edicionit 2020-2021. “Bordi i FBK-së ka marrë vendim që ta shtyjë fillimin e edicionit të ri për një muaj, më saktësisht që edicioni i ri të fillojë më 14.10.2020, kur edhe do të organizohen ndeshjet e Superkupës së Kosovës”, thuhet në njoftimin e FBK-së.

Ndeshjet e ‘play-out’-it gjithashtu do të shtyhen për një muaj. Ky vendim është marrë

duke parë gjendjen e pandemisë Covid-19 në vendin tonë, por edhe pas konsultimeve me autoritetet përkatëse në nivel vendor dhe në pajtim me udhëzimet e profesionistëve shëndetësorë duke pasur në vëmendje dhe radhë të parë shëndetin e lojtarëve, trajnerëve, punëtorëve sportivë dhe të gjithë aktorëve të përfshirë në organizimin e garave të basketbollit, si dhe karakteristikat e sportit në Kosovë. FBK-ja pret nga institucionet e vendit që varësisht prej situatës me pandeminë Covid-19 të marrë vendim për lejimin e zhvillimit të stërvitjeve në mënyrë që klubet të fillojnë ngadalë, por sigurt përgatitjet për edicionin e ri.

Federata e Basketbollit të Kosovës e ka përgatitur Udhëzuesin për Rikthimin në Fushat e Basketbollit (versionin



3.0) dhe në momentin që Qeveria e Republikës së Kosovës merr vendim për lejimin e zhvillimit të stërvitjeve (dhe më pas edhe garave), atëherë FBK-ja do t'i pajisë të gjithë anëtarët e saj me këtë Udhëzues, i cili do të jetë udhërrëfyes për ruajtjen e shëndetit të të gjithë basketbollistëve/eve, zyrtarëve të ekipit, zyrtarëve të ndeshjeve dhe gjithë komunitetit të basketbollit në vendin tonë. Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës.

Duhet të thellohet bashkëpunimi në mes të FBK-së dhe DSK-së

Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu dhe sekretarja e përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, kanë pritur në një takim menaxherin në Departamentin e Sporteve të Kosovës, Arsim Thaqi. FBK-ja ka njoftuar se tema e diskutimit ka qenë bashkëpunimi në mes të Federatës së Basketbollit dhe Departamentit të Sportit dhe

koordinimi sa më i mirë i punëve për të ardhmen. Kryetari i FBK-së në fund të takimit ia dhuroi një top të lojës së basketbollit 3x3, një fanellë të Përfaqësueses A të Kosovës dhe Udhëzuesin për Trajnerë - Niveli 1, publikimi i të cilit është financuar nga MKRS-ja dhe DSK-ja. Federata e Basketbollit të Kosovës falënderon Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport të Kosovës dhe Departamentin e Sportit të Kosovës për kontributin e dhënë për zhvillimin e sportit të basketbollit në vendin tonë.

Prishtina e humbet me rezultat zyrtar ndeshjen ndaj Lincolnit

PRISHTINË, 24 GUSHT - FC Prishtina e ka humbur me rezultat zyrtar ndeshjen ndaj Lincolnit, kurse të hënën pasdite e ka pranuar vendimin e UEFA-s dhe për këtë vendim ka njoftuar përmes faqes zyrtare. Në rastin e parë të Prishtina ishin

tetë raste me Covid-19, pas testimit të bërë në Gjibraltari. Skuadra u kthye në Kosovë pa luajtur ndeshjen. U formua shpejt një skuadër tjetër, me lojtarë të huazuar nga klubet e tjera të Superligës. Prapë tetë lojtarë dolën me koronavirus dhe ndeshja nuk

u zhvillua. Dhe ashtu siç pritej, Prishtina u eliminua me vendim zyrtar të UEFA-s 3:0 në ndeshjen ndaj skuadrës nga Gjibraltari, Lincoln. Kjo ndeshje ishte anuluar dy herë për shkak të rasteve pozitive me Covid-19 te skuadra prishtinase.



Të enjten shorti për edicionin e ri në futboll

PRISHTINË, 24 GUSHT - Të enjten (27 gusht) nga ora 13:00 në selinë e Federatës së Futbollit të Kosovës do të bëhet tërheqja

e shortit për edicionin e ri të garave në Superligën e Kosovës në futboll. Kështu ka bërë me dije FFK-ja me anë të një

njoftimi për media. Po të njëjtën ditë nga ora 13:30 do të tërhiqet edhe shorti për dy grupet e Ligës së Parë.

Ndërkohë, një ditë më pas, nga ora 11:00, do të bëhet tërheqja e shortit për edicionin e ri në Ligën e Dytë.



Formacioni i sezonit në Ligën e Kampionëve

LISBONË, 24 GUSHT - Pas përfundimit të edicionit 2019/20 në garën më të fortë të futbollit për klube në Evropë, Liga e Kampionëve, është

UEFA që tashmë ka zgjedhur formacionin më të mirë për sezonin që lamë pas. Në 11-shën më të mirë vend kanë zënë katër futbollistë të kam-

pionit aktual Bayern Munchen. Numër të njëjtë të futbollistëve në formacion ka edhe finalisti tjetër Paris Saint-Germain.

Formacioni më i mirë: Neuer, Kimmich, Marquinhos, Kimpembe, Bernart, Sterling, Sabitzer, Di Maria, Gnabry, Lewandowski, Haaland.



Flick: Në nëntor askush nuk kishte frikë nga Bayerni

Hans Flick është kthyer në hero në pak muaj. Tre trofe të fituar, ndërkohë që e mori drejtimin e Bayern Munichut në muajin nëntor. Fitore të njëpasnjëshme në kampionat, kontratë dhe në fund titull, Kupë dhe Ligë të Kampionëve. "Jam krenar për ekipin", ka thënë Flick. "Kur pashë titujt në media në nëntor, gjithçka lexova ishte se askush nuk kishte më frikë nga Bayerni. Nga atëherë zhvillimi i ekipit ka qenë i çmendur. E meritua të fitonim për shkak të gjysmës së dytë të sezonit. Ju mund ta shihnit stërvitjen që u bë në janar dhe që aty kuptohej se diçka e madhe po rritej. Ekipi kishte një dëshirë shumë të madhe për të fituar", ka shtuar Flick.



Tuchel: Jam krenar me paraqitjen e PSG-së

Trajneri i Paris Saint-Germainit, Thomas Tuchel, është shprehur krenar me mentalitetin e skuadrës së tij. Parisi pësoi 1:0 nga Bayerni në finale të Championsit. "Ishte një finale super e fortë, dallimi i së cilës ishte një gol i shënuar. Jam krenar me mentalitetin tonë dhe me atë se si kemi luajtur në ndeshjet e fundit. Është e tëra që mund të kërkosh si trajner. Po, jam i dëshpëruar, por jo edhe tepër", ka thënë Tuchel. "Ne kemi dhënë çdo gjë. Kemi lënë zemrën dhe çdo gjë tjetër në fushë. Ju mund të prisni këtë në finale, asgjë më shumë. Ne nuk mund ta kontrollojmë rezultatin. Kam menduar se një gol mund ta vendosë këtë ndeshje", ka shtuar Tuchel.



Kimmich: Tani mund të vdes i qetë

Një trofe që i mungonte aq shumë, Joshua Kimmich tani mund të vdesë i qetë. Trofeu i Ligës së Kampionëve është në duart e tij. Gjermani shpërtheu në lot pas përfundimit të ndeshjes duke bërë titull nga gëzimi. "Është dita më e bukur e karrierës sime. Kur fiton një trofe të tillë me vëllezërit e tu në fushën e lojës, është një ndjesi e papërshtueshme. Jam shumë i lumtur", ka thënë mesfushori gjerman që në ndeshjet e fundit luajti mbrojtës i djathtë në vend të francezit Pavar që ishte i dëmtuar. I pyetur nëse ky ishte trofeu më i rëndësishëm në karrierën e tij, Kimmich ka deklaruar: "Në rang klubesh po. Tani mund të vdes i qetë (qesh), por sigurisht që nuk dua të ndalem me kaq, pasi dua të fitoj sërish në të ardhmen. Ishte një sezon



fantastik nga e gjithë skuadra, fituam gjithçka në një kohë aspak të lehtë. Tani do të festojmë dhe më pas do të mendojmë për të ardhmen, mezi po presim të kthehemi në shtëpi me trofeun në duar. Liga e Kampionëve është edhe për tifozët të cilët na kanë mbështetur pa masë gjatë sezonit", ka deklaruar Kimmich.

Silva: Kjo ishte ndeshja ime e fundit me PSG-në



Tiago Silva luajti ndeshjen e fundit me skuadrën e PSG-së. Kapiteni brazilian ka thënë se po largohet i zhgënjyer nga ky ekip, por një ditë do të rikthehet sërish në një tjetër rol. "Kjo ishte ndeshja ime e fundit me PSG-në. Jam shumë i zhgënjyer. Më vjen keq dhe dua t'u kërkoj falje tifozëve që më kanë dhënë shumë dashuri. Unë do të rikthehem në Paris, skuadrën që e kam dashuruar gjithmonë. Do të vij për të bërë një tjetër rol. Unë dua që të luaj të paktën edhe 3-4 vjet të tjera në mënyrë që të arrij në Botërorin e Katarit në vitin 2022. Më vjen keq që nuk arrita ta fitoja dot Ligën e Kampionëve këtë vit", ka thënë Silva.

Di Maria: Ne dhamë jetën pas kësaj fanelle

PSG-ja nuk arriti dot ta fitonte Ligën e Kampionëve pasi u mund në finale nga Bayern Munchen (1-0). Pas finales së humbur Angel Di Maria ka bërë një postim në rrjetet sociale. "Ne luftuam deri në sekondën e fundit. Ne dhamë jetën pas kësaj fanelle. Ne gjithmonë do të përpiqemi ta mbajmë atë në maksimumin e mundësisë. Sot ne nuk ishim në gjendje të kapërcejmë një vit të jashtëzakonshëm, por futbollit na lejon të hakmerremi dhe e di që një ditë ky klub do ta bëjë në Ligën e Kampionëve. Faleminderit për ultrasit



që na mbështeten pa kushte. Ne do të vazhdojmë të luftojmë si gjithmonë. Përpara Paris", ka shkruar Di Maria.

Lewandowski: Kurrë mos u dorëzo kur dështon

Sulmuesi i Bayern Munchenit, Robert Lewandowski, pas triumfit në finale të Ligës së Kampionëve ndaj PSG-së (1-0), ka thënë se njeriu duhet të mos dorëzohet edhe kur dështon. "Gjithmonë ëndërro. Kurrë mos u dorëzo kur dështon", ka shkruar sulmuesi polak në "Instagram". "Puno zellshëm për ta arritur synimin. Faleminderit për përkrahje dhe që u keni besuar aftësive tona. Ne jemi kampionë të Evropës!", ka shtuar Lewandowski.





REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTIT
 REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT
 REPUBLIKA KOSOVO – KANCELARIJA PREDSEDNIKA

Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës,
 Në mbështetje të nenit 36 të Rregullores (P) Nr. 04/2016 për Llojet e Dekoratave dhe Procedurat për Dhënien dhe Revokimin e tyre, nenit 2 të Rregullores (P) Nr. 01/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (P) Nr. 04/2016 për Llojet e Dekoratave dhe Procedurat për Dhënien dhe Revokimin e tyre, i miratuar me Dekretin Nr. 112/2020 të datës 14.08.2020, shpall:

**KONKURS PUBLIK
 PËR PËRZGJEDHJEN E MODELEVE TË DEKORATAVE QË JEP
 PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Përshkrimi:

1. Më qëllim të përzgjedhjes së modeleve të dekoratave që jep Presidenti i Republikës, Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës fton të gjithë personat fizik dhe juridik që të aplikojnë me propozimet e tyre për modelin e dekoratës, si në vijim:

1.1. Urdhri “Adem Demaçi”

- Pas mbylljes së aplikimit për propozime, për modelin e Dekorates, Sekretari emëron Komisionin për shqyrtimin e propozimeve të pranuar nga shpallja publike.
- Komisioni, pas shqyrtimit të propozimeve për modele të dekoratave, i rekomandon Presidentit deri në tri modele për dekoratë.
- Presidenti vendos për modelin e dekoratës përkatese.
- Personi, propozimi i të cilit zgjidhet për model të një dekorate, pas përzgjedhjes duhet të përgatis modelin e dekoratës sipas kërkesave për prodhimin e tyre.
- Personi, propozimi i të cilit zgjidhet për model të një dekorate shpërblehet me një mijë (1,000.00) Euro, pasi të ketë përgatitur modelin e dekoratës siç është përcaktuar në pikën 5.
- Të drejtat e autorit barten nga propozuesi tek Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës për propozimet e përzgjedhura, për modele të dekoratave, ku më pastaj bëhet punimi i dekoratave në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Kushtet për aplikim me propozime:

- Të drejtë aplikimi me propozime për modele të dekoratave kanë personat fizik dhe juridik.
- Propozimet duhet të dërgohen me shifra.
- Propozimet duhet të dorëzohen në letër dhe në formë elektronike (CD).
- Propozimet për dekorata duhet të jenë në pajtim me praktikën evropiane për dekorata.
- Secili propozim duhet të jetë i ndarë në pliko të veçantë.

Afati dhe dorëzimi i propozimeve:

Afati i dorëzimit të propozimeve është 09 shtator 2020.

Propozimet dorëzohen në recepcionin e Ndërtesës së Kuvendit të Kosovës në Prishtinë (rruga Nëna Terezë p.n.) apo përmes postës, në pliko të mbyllura.

Propozimet dorëzohen në këtë adresë:

**Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës
 Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, p.n. Prishtinë
 10 000**

**Propozimi për Dekoratë: Urdhri “Adem Demaçi”
 Nga: Shifra e personit**

Për sqarime shtesë shihni Rregulloren (P) Nr. 04/2016 për Llojet e Dekoratave dhe Procedurat për Dhënien dhe Revokimin e tyre

https://president-ksgov.net/repository/docs/2020_08_13_111150_1_RREGULLORE_P_R_LLOJET_E_DEKORATAVE_DHE_PROCEDURAT_P_R_DH_NIEN_DHE_REVOKIMIN_E_TYRE.pdf

Për informata të tjera plotësuese mund të drejtoheni në e-mail adresën: alban.halili@president-ksgov.net



REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTIT
 REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT
 REPUBLIKA KOSOVO – KANCELARIJA PREDSEDNIKA

Kancelarija predsednika Republike Kosovo,
 U skladu sa članom 36. Uredbe (P) br. 04/2016 o vrstama odlikovanja i postupcima njihovog dodeljivanja i oduzimanja, članom 2. Uredbe (P) br. 01/2020 o izmenama i dopunama Uredbe (P) br. 04/2016 o vrstama odlikovanja i postupcima njihovog dodeljivanja i oduzimanja, usvojena Dekretom br. 11/2020, od 14.08.2020. godine, raspisuje:

**JAVNI KONKURS
 ZA IZBOR MODELA ODLIKOVANJA KOJE DODELJUJE
 PREDSEDNIK REPUBLIKE KOSOVO**

Opis:

1. U cilju izbora modela odlikovanja koje dodeljuje predsednik republike, Kancelarija predsednika Republike Kosovo poziva sva fizička i pravna lica da apliciraju sa svojim predlozima za model odlikovanja, kao u nastavku:

1.1. Ordenje „Adem Demaçi“

- Nakon isteka roka za apliciranje za predloge za model odlikovanja, sekretar imenuje Komisiju za razmatranje predloga, primljenih iz javnog konkursa.
- Komisija, nakon razmatranja predloga za modele odlikovanja, preporučuje predsedniku do tri modela za odlikovanje.
- Predsednik odlučuje o modelu odlikovanja.
- Lice, čiji je predlog izabran za modela odlikovanja, nakon izbora, treba da priprema model odlikovanja u skladu sa zahtevima za njihovu proizvodnju.
- Lice, čiji je predlog izabran za modela odlikovanja, biće nagrađen iznosom od hiljadu (1,000.00) evra, nakon pripremanja modela odlikovanja, kao što je utvrđeno u tački 5.
- Autorska prava prenose se od predlagača na Kancelariju predsednika Republike Kosovo za izabrane predloge, za modele odlikovanja, i zatim se vrši izrada odlikovanja u skladu sa važećim zakonodavstvom.

Uslovi za apliciranje sa predlozima:

- Pravo na apliciranje sa predlozima za modele odlikovanja imaju fizička i pravna lica.
- Predloge treba dostaviti šiframa.
- Predloge treba dostaviti na papiru i u elektronskom obliku (CD).
- Predlozi za odlikovanja trebaju biti u skladu sa evropskim praksama za odlikovanja.
- Svaki predlog treba da bude odvojen u zasebnim kovertama.

Rok i dostavljanje predloga:

Rok za dostavljanje predloga je 9. septembar 2020. godine.

Predlozi se dostavljaju na recepciji zgrade Skupštine Kosova u Prištini (ulica Majka Tereza bb) ili poštom, u zapečaćenim kovertama.

Predlozi se dostavljaju na ovu adresu:

**Kancelarija predsednika Republike Kosovo
 Zgrada Skupštine Kosova bb, Priština
 10 000**

**Predlog za odlikovanje: Ordenje „Adem Demaçi“
 Od: Šifra lica**

Za detaljna objašnjenja vidi Uredbu (P) br. 04/2016 o vrstama odlikovanja i postupcima njihovog dodeljivanja i oduzimanja

https://president-ksgov.net/repository/docs/2020_08_13_111150_1_RREGULLORE_P_R_LLOJET_E_DEKORATAVE_DHE_PROCEDURAT_P_R_DH_NIEN_DHE_REVOKIMIN_E_TYRE.pdf

Za dodatne informacije možete nas kontaktirati na e-mail adresu: alban.halili@president-ksgov.net

C.nr.439/2020

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, i përbërë nga gjyqtari i vetëm **Betim Behluli**, në çështjen juridike të paditëses Teuta Sokoli nga Rahoveci, të cilën e përfaqëson Byroja për Konsulencë Juridike "Tarani", kundër të paditurit Kajtaz Gashi nga fshati Llapushnik, Komuna e Skenderajt, tani me adresë të pa njohur, për shkak të zgjidhjes së martesës, me dt.20.08.2020, merr këtë:

A K T V E N D I M

Të paditurit Kajtaz Gashi nga fshati Llapushnik, Komuna e Skenderajt, tani me adresë të pa njohur, I CAKTOHET përfaqësuesi i përkohshëm avokat Adhurim Bugari nga Rahoveci.

Në kuptim të nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë i padituri apo përfaqësuesi i tij me prokurorë, gjegjësisht derisa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Ky aktvendim do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në një nga gazetatat e përditshme ditore, si dhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

A r s y e t i m

Paditësja Teuta Sokoli nga Rahoveci, të cilën e përfaqëson Byroja për Konsulencë Juridike "Tarani", ka ushtruar padi për shkak të zgjidhjes së martesës kundër të paditurit Kajtaz Gashi nga fshati Llapushnik, Komuna e Skenderajt, tani me adresë të pa njohur,

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë dhe pas pranimit të parashtresës me datë 17.08.2020 me të cilën përfaqësuesi i autorizuar ka propozuar në këtë çështje kontestimore të caktojë një përfaqësues të përkohshëm që i njëjti t'ia mbrojë të drejtat deri sa të paraqitet në gjykatë vetë i padituri respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftojë gjykatën për caktimin e kujdestarit, pasi që i padituri Kajtaz Gashi nuk gjendet në vendbanimin dhe vendqëndrimin e tij të fundit e QPS në Glllogoc ka konstatuar se të njëjtit e kanë vizituar familjen e të paditurit dhe ata kanë deklaruar se i padituri nuk gjendet në Kosovë.

Duke vendosur sipas propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 79.3 të LPK-së, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit dhe se përfaqësuesi i përkohshëm av. Adhurim Bugari nga Rahoveci, është pajtuar që ta përfaqësojë të paditurin e lartcekur në këtë çështje juridiko - civile.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË- DEGA NË RAHOVEC,

C.nr.439/2020, me datë 20.08.2020

Gjyqtari
Betim Behluli

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit, Divizioni Civil në Prishtinë.

Shpallje për gazetë

Ofertë për shitjen e patundshmërisë

Rexhep (Ramë) Thaqi, me adresë në fsh. Piranë KK Prizren, është bashkëpronar me pjesën prej 3/25 e pjesës ideale (rreth 1436.5 m²), të patundshmërisë, me numër të Njesisë kadastrale P-71813064-01256-0, në vendin e quajtur "Maoçak-Maçak", me kulturë bujqësore – arë e kl.5, në sipërfaqe të përgjithshme prej 11971 m², Zona kadastrale Piranë.

Nga pjesa e vet ideale oferton për shitje, siq vijon:

-sipërfaqen prej 600 m² të patundshmërisë me të dhënat si më lart, në shumën e përgjithshme prej (600 m² x 1.400 € = 8.400 €) (me shkronja: Tetëmijë e katërqind euro),
-sipërfaqen prej 500 m² të patundshmërisë me të dhënat si më lart, në shumën e përgjithshme prej (500 m² x 1.400 € = 7.000 €) (me shkronja: Shtatëmijë euro).

Prizren, 24.08.2020

Ofertuesi,
Rexhep Thaqi

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPIJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr-4- 111-39434

Datë: 24.08.2020

Në bazë të Nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), Nenit 5, pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, Nenit 4 dhe 5, të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Drejtoria Komunale e Arsimit në Lipjan shpall:

KONKURS
Për plotësimin e vendeve të punës**IX. SHFMU "Ibrahim Banushi" Shalë**

Një (1) Mësues/e klase (Vend i lirë)

Kushtet e kërkuara:

Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Aplikacioni i plotësuar (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë sporteli nr. 3);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomë (Certifikatë) fotokopje të vërtetuar nga organi përkatës
- Certifikata që nuk jeni nën hetime.
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Kriteret e kualifikimit:

Përgatitje adekuate profesionale, në bazë të normativit 10/2018 (MASHT),

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT.

Për intervistë do të ftohet ata kandidat të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura.

Informimi i kandidatëve aplikues rreth mbajtjes së testit me shkrim, intervistës me gojë dhe shpallja e rezultateve do të bëhet në Web faqen e Komunës së Lipjanit <https://kk.rks-gov.net/lipjan/> dhe në tabelën e shpalljeve.

Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, nuk do të jetë domosdoshmërisht më datë 01.09.2020, por në varësi të liritimit real i vendit të punës (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.).

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit.

Dokumentet e pranura nuk kthehen.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

NJOFTIM

Zyra Kombëtare e Auditimit njofton se në bazë të Vendimit Nr. 112/1523 për çështje administrative anulohet konkursi për plotësimin e dy vendeve të punës për pozitën "**Auditor Junior për auditimin e rregullsisë**", me numër reference AJ/ZKA/13-07/20 e publikuar në gazetën e përditshme online Epoka e Re me datën 31 korrik 2020.

Kërkojmë mirëkuptim nga pjesëmarrësit në konkurs.

Divizioni i Burimeve Njerëzore

24 gusht 2020

OBAVEŠTENJE

Nacionalna Kancelarija Revizije obaveštava da se osnovu Odluke Br. 112/1523 zbog administrativne svrhe anulira konkurs za popunjavanje dva radna mesta za položaj "**Revizor Junior za reviziju regularnosti**", sa referentnim brojem AJ/ZKA/13-07/20 objavljeno u online dnevnom listu Epoka e Re dana 31 Juli 2020.

Tražimo razumevanje od učesnika na konkursu.

Odeljenje Ljudskih Resursa

24 Avgust 2020



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr. 205/1
 Dt. 24.08.2020

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE PËR VITIN SHKOLLOR 2020/2021 KLASËT E 10-ta PËR VIJUES NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË PROFESIONAL - MESIMI PER TE RRRITUR

Për plotësimin e vendeve të lira regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Shkollën e Mesme të Lartë Profesionale "Shtjefën Gjeçovi" në Prishtinë, shpallim këto drejtime:

I. MAKINERI

- | | |
|--|----------------|
| 1. Metalpunues | 2 PARË.- 24nx. |
| 2. Inst.i Ujës. dhe Kanali.Inst. i Ngr.Klim. | 2 PAR.- 24nx. |
| 3. Automekanik | 2 PAR. 24nx. |
| 4. Dirigjimi kompjuterik i makinave | 1 PAR.- 24nx. |

II. TEKSTIL

- | | |
|-----------------|---------------|
| 1. Konfeksioner | 2 PAR.- 24nx. |
| 2. Rrobaqepës | 1 PAR.- 24nx. |

III. TRANSPORT DHE TRAFIK

- | | |
|-----------------------|---------------|
| 1. Transport rrugor | 2 PAR.- 24nx. |
| 2. Trafik rrugor | 2 PAR.-24 nx. |
| 3. Drejtues i Trenave | 2 PAR.- 24nx. |

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, për vijimin e mësimin për të rritur në shkolla profesionale, për vitin shkollor 2020/2021, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe që janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftësive në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të shkollave profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)

Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe

Certifikatën e lindjes.

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve, bëhet 15 ditë nga dita e shpalljes. Dorëzimi i dokumenteve bëhet në lokalet e shkollës SHMLP "Shtjefën Gjeçovi" në Prishtinë, nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollën përkatëse 3(tri) ditë pas mbylljes së konkursit.

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Agjencisë së Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



Br.13/491
Dana: 24.08.2020
D r a g a s

Na osnovu Zakona o pred univerzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo br.04 / L-032, člana 8 Zakona o radu u Republici Kosovo, br.03 / L-212, člana 5 Zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo br.03 / L-068, Administrativno uputstvo (MONT) br.10 / 2018 od 20.07.2018 o normativu o stručnom kadru opšteg obrazovanja, Administrativno uputstvo br.05 / 2015- normativ za nastavnike stručnog obrazovanja, Administrativno uputstvo Br. 2017/2017, za regulisanje postupaka za konkursa u javnom sektoru, odluka MONT-a br. 32 / 01B, odluka MONT-a br. 311 / 01B od 04. avgusta 2015. godine, zahtev MONT-a br.2-2955 od 01. jul 2016. Opštinska direkcija za obrazovanje u Dragašu objavljuje:

KONKURS- Ponovo se objavljuje

Za popunjavanje slobodnih mesta za predškolsko, niže i srednje srednjoškolsko obrazovanje opštine Dragaš za školsku 2020/2021 godinu.

OSNS "9 Maji" Rapča

1. Jedan nastavnik za muzicko vaspitanje(Bosanski)

OSNS "Zenuni" Brod

1. Jedan nastavnik za razredun nastavu(Bosanski)
2. Jedan nastavnik za Fiziku(Bosanski)
3. Jedan nastavnik za Biologiju(Bosanski)
4. Jedan nastavnik za likovno vaspitanje(Bosanski)

OSNS "Svetlost"- Krušev

1. Jedan nastavnik za Hemiju(Bosanski)
2. Jedan nastavnik za razrednu nastavu Zlipotok(Bosanski)

OSNS "Restelica"

1. Jedan nastavnik za Matematiku(Bosanski)
2. Jedan nastavnik za Fiziku (12 časa) (Bosanski)
3. Jedan nastavnik za hemiju (10 časa) (Bosanski)
4. Jedan nastavnik za Historiju(Bosanski)
5. Jedan nastavnik za Geografiju(Bosanski)
6. Tri nastavnika za razredun nastavu(Bosanski)

SHML"Ruzhdi Berisha" Dragaš

Nastava na bosanskom jeziku

1. Profesor stručne prakse u obrazovnom profilu Opšte sestinstvo(Bosanski)

I. Ovi dokumenti se trebaju priložiti uz prijavu:

- Obrazac za prijavu (dobija se u ODO gde se prijave podnose sa drugim relevantnim dokumentima.);
- Lični dokument (kopija lične karte ili pasoša);
- Diploma mora biti overena originalom, u suprotnom se ne smatra važećom (ili potvrde), uverenja umesto diplome moraju biti overena kod javnog Notera i ne starija od šest meseci;
- Kandidati koji su završili studije izvan Republike Kosovo moraju doneti nostrifikovani diplomu;
- Potvrdu da osoba nije pod istragom;
- Dokaz iskustva u obrazovnim ustanovama (ako ih ima).

Početak rada na gore pomenutim mestima neće nužno biti 01.09.2020., Već u zavisnosti od stvarnog oslobadjanja radnog mesta u IEAA (datum penzionisanja ili porodiljskog odsustva, itd.).

Konkurs ostaje otvoren **8 dana** od dana objavljivanja u medijima.

Napomena: Popunjena konkursna dokumentacija se ne vraća kandidatima.

Datum: 24.08.2020
Dragas



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



Nr.13/491
Më: 24.08.2020
D r a g a s h

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës, nr.03/L-212, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.10/2018 të datës 20.07.2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ nr.05/2015- normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, vendimin e MASHT nr.232/01B, vendimin e MASHT nr.231/01B të datës, 04 Gusht 2015, kërkesën nga MASHT ref.2-2955 të datës 01 Korrik 2016. Drejtoria Komunale për Arsim në Dragash, shpall:

KONKURS- rishpallet

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për arsimin parafillor, fillor të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të Komunitet së Dragashit për vitin shkollor 2020/2021.

SHFMU "9 Maji" Rapçë

1. Një mësimdhënë për muzikë (Boshnjakisht)

SHFMU "Zenuni" Brod

1. Një mësimdhënë për mësim klasor(Boshnjakisht)
2. Një mësimdhënë për Fizikë (Boshnjakisht)
3. Një mësimdhënë për Biologji(Boshnjakisht)
4. Një mësimdhënë për art figurativ(Boshnjakisht)

SHFMU "Svetlost"- Kruševë

1. Një mësimdhënë për Kimi(Boshnjakisht)
2. Një mësimdhënë për mësim klasor në Zlipotok(Boshnjakisht)

SHFMU "Restelica"

1. Një mësimdhënë për Matematikë(Boshnjakisht)
2. Një mësimdhënë për Fizikë (12 orë) (Boshnjakisht)
3. Një mësimdhënë për Kimi (10 orë) (Boshnjakisht)
4. Një mësimdhënë për Histori(Boshnjakisht)
5. Një mësimdhënë për Gjeografi(Boshnjakisht)
6. Tre mësimdhënë për mësim klasor(Boshnjakisht)

SHML"Ruzhdi Berisha" Dragash

Mësimi në gjuhën boshnjake

1. Një mësimdhënë i lëndës së praktikës profesionale në profilin arsimor Infermjeri i përgjithshëm(Boshnjakisht)

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në DKA ku dorëzohen aplikacionet me dokumentet tjera përkatëse.);
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës);
- Diploma duhet të jetë e vërtetuar nga origjinali, në të kundërtën nuk merret si valide (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj;
- Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës, duhet të sjellin diplomën e nostrifikuar;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, nuk do të jetë domosdoshmërisht më datë 01.09.2020, por në varësi të lirimit real të vendit të punës në IEAA (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.).

Konkursi mbetet i hapur **8 ditë** nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Vërejtje: Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk iu kthehet kandidatëve.

Datë: 24.08.2020
Dragash





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

